



PROFESIONET MË TË KËRKUARA ◀▶ EKONOMIA SHQIPTARE KA NEVOJË PËR AFTËSI TË MIRA
 THE MOST NEEDED PROFESSIONS ◀▶ ALBANIAN ECONOMY NEEDS GOOD SKILLS

Tiranë, 3 Nëntor 2015 – Tirana, 3rd of November
 Tirana Business Park

PROFESIONET MË TË KËRKUARA ◀▶ EKONOMIA SHQIPTARE KA NEVOJË PËR AFTËSI TË MIRA

Rezultate dhe Rekomandime të Konferencës Kombëtare 3 Nëntor 2015

Frank Hantke (Ed.)

Rezultate dhe Rekomandime të Konferencës Kombëtare 3 Nëntor 2015

(ed.) **Z. Frank Hantke**, *Drejtor Friedrich Ebert Stiftung, Zyra e Tiranës*



Rezultate dhe Rekomandime të Konferencës Kombëtare:

PROFESIONET MË TË KËRKUARA ◀▶ EKONOMIA SHQIPTARE KA NEVOJË PËR AFTËSI TË MIRA

Botimi i broshurës u mundësua nga:

Fondacioni “Friedrich Ebert”

Zyra e Tiranës

Rruga, “Abdi Toptani”, Torre Drin, Kati 3-të, Kutia Postare 1418

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 04 2250986 / 04 2273306; Fax: +355 04 22622067

www.fes-tirana.org

Viti i botimit: 2016

Përpunim grafik dhe shtyp: Albdesign PSP

ISBN: 978-9928-215-00-0

Përkthyer nga: Evi Konjari & Adelina Albrahimi

Frank Hantke (editor)

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Konferencë Kombëtare

PROFESIONET MË TË KËRKUARA ◀▶ EKONOMIA SHQIPTARE KA NEVOJË PËR AFTËSI TË MIRA

APEL I VULLNETIT TË MIRË

Rritja ekonomike në Shqipëri kërkon arsim dhe formim të orientuar drejt së ardhmes

Shqipëria është vend i pasur me burime njerëzore dhe natyrore. Me qëllim përdorimin e tyre në mënyrën e duhur dhe një rritje ekonomike të qëndrueshme, Shqipëria ka nevojë për një sistem arsimit dhe formimit i cili zhvillon aftësitë e nevojshme për ekonominë e vendit sot dhe nesër.

Për të qenë konkures, punëdhënësve ju nevojitet një forcë e aftë pune

Të qenit një vend tërheqës për investime dhe rritja e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve siguron konkureshmërinë e ekonomisë në kontekstin vendor dhe atë europian. Prandaj, Shqipëria duhet të përshpejtojë zbatimin e politikave të saj për arsimin dhe formimin të cilat i japin përparësi fuqizimit të punësueshmërisë së brezit të ri si në sektorin jo-akademik ashtu dhe në atë akademik në masë të barabartë.

Arsimi dhe formimi i orientuar drejt së ardhmes kanë nevojë për kontributin e punëdhënësve

Punëdhënësit janë aktorët më të aftë për të përcaktuar se cilat aftësi nevojiten si sot ashtu edhe nesër. Prandaj, ato duhet të luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e kurrikulave për arsimin dhe formimin profesional në të gjitha nivelet. Veç kësaj, punëdhënësit duhet të përfshihen edhe në drejtimin e shkollave dhe të jenë pjesë e komisioneve të provimeve.

Ofertat për eksperiencë në punë praktike – një element kyç në arsim dhe formim

Vendi i punës i së nesërme kërkon aftësi dhe kompetenca të cilat jo vetëm që mësohen në shkollë por edhe përftohen nëpërmjet eksperiencës së punës praktike në kompani. Kombinimi i teorisë me praktikën është thelbësor për përgatitjen e fuqisë punëtore për tregun e punës. Ky duhet të kthehet në parim për arsimin në të gjitha nivelet.

Punëdhënësit duhet t'ju ofrojnë mundësi punëmarrësve të ardhshëm

Punëdhënësit kanë përgjegjësi për formëzimin e fuqisë punëtore të së ardhshmes. Ato duhet t'i hapin dyert e tyre për të ofruar stazhe pune, praktika për kursantët, çirakëri/punë praktike dhe mundësi të tjera për mësimnxënie praktike dhe të strukturuar në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare për arsimin dhe formimin.

Bashkëpunimi me kompanitë duhet të jetë i zbatueshëm

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e punëdhënësve, qeveria duhet të zhvillojë mekanizmat e duhur për kapërcimin e pengesave të cilat nuk i lejojnë punëdhënësit për të pritur stazhierë, kursantë apo praktikantë/çirakë. Duhet gjetur zgjidhje për çështje të ndryshme, duke përfshirë sigurimin shëndetësor, sigurimin e jetës dhe atë shoqëror, mbulimin e dëmit, burimet njerëzore përgjegjëse për mbikqyrjen, logjistikën si edhe kostot e transportit.

Shkollat dhe qendrat e formimit duhet të jenë ndërmjetësuese

Shkollat dhe qendrat e formimit duhet të marrin përsipër rolin e tyre si ndërmjetësuese midis nxënësve/kursantëve dhe punëdhënësve të mundshëm. Kjo kërkon burime financiare dhe njerëzore, përkushtim dhe njohuri.

Njohja e përgjegjësisë së përbashkët nga të gjithë partnerët

Arsimi dhe formimi profesional cilësor është vendimtar për të ardhmen e shqiptarëve. Prandaj, qeveria, shkollat, universitetet, shkenca dhe partnerët ekonomikë pritet që të angazhohen për një bashkëpunim të ngushtë dhe përgjegjësi të përbashkët me qëllim paisjen e fuqisë punëtore në Shqipëri me aftësitë e duhura për të qenë të gatshëm për të ardhmen.

Përmbajtja

Apeli i Vullnetit të mirë	3
Përmbajtja	4
Shënim i organizatorëve Hantke / Hartig / Kasten	5
Programi i konferencës	7
Helmut Hoffmann Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë	
Formimi Profesional dhe Aftësitë e Mira si Shtylla Kryesore e një Ekonomie të Suksesshme	8
Edi Rama, Kryeministër I Republikës së Shqipërisë	
Punësimi ka nevojë për Aftësi – Ekonomia ka nevojë për Punësim	10
Arben Ahmetaj, <i>Ministër për Zhvillimin Ekonomik, Turizmin, Tregtinë dhe Sipërmarrjen</i>	
Si të përshtasim Nevojat e Biznesit dhe Aftësitë e Orientuara drejt Punësimit të rinjve	12
Blendi Klosi, <i>Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë</i>	
Si të përshtasim Nevojat e Biznesit dhe Aftësitë e Orientuara drejt Punësimit të rinjve	14
Jürgen Hollstein, <i>Drejtor Ekzekutiv (CEO), Organizata Gjermane e Punëdhënësve për Formim Profesional dhe Formim të Mëtejshëm</i>	
Si të përshtasim Nevojat e Biznesit dhe Aftësitë e Orientuara drejt Punësimit të rinjve	16
Fotografi,	
Tregu i Mundësive	18
Paneli: Ndërtimi & Infrastruktura,	
Anette Kasten	20
Paneli: Industria Tekstile & e Lehtë,	
Sonila Limaj	22
Paneli: Kujdesi Shëndetësor & Kujdesi për të Moshuarit,	
Skënder Dule	24
Paneli: Turizmi,	
Etleva Vertopi	26
Frank Hantke, Drejtor, FES	
Një politikë arsimore gjithëpërfshirëse dhe e orientuar drejt profesionit është çelësi për zhvillimin e ekonomisë shqiptare	28
Autorët, Folësit, Moderatorët, Reporterët	33
Listë e publikimeve të tjera të profilit	33
Foto të Konferencës	35

Shënim i organizatorëve

Konferenca „Profesionet më të kërkuara ◀▶ Ekonomia shqiptare ka nevojë për aftësi më të mira” u zhvillua më 3 nëntor 2015 në Tirana Business Park, një vend, ku sot krijohen shanse të reja për zhvillimin ekonomik.

Kjo është konferenca e dytë në lidhje me këtë temë të rëndësishme, për të cilën në Tetor 2013 me titullin „Zhvillimi ekonomik ◀▶ Arsimi profesional ◀▶ Mirëqënie për Shqipërinë“ u hodh hapi i parë mbi projektet dhe aktorët e arsimit profesional në Shqipëri.

Në atë kohë, të njëjtët organizatorë, e vunë theksin mbi temën “Arsimi profesional dhe rëndësia e tij në zhvillimin ekonomik” dhe e sollën atë në axhendën politike. Që prej asaj kohe, pyetja se si arsimi dhe kualifikimi mund të përshtaten me nevojat në vend është pjesë e çdo diskutimi serioz politik mbi zhvillimin ekonomik shqiptar.

Me konferencën pasuese u bë hapi tjetër. Aktorët kryesorë për zhvillimin e një kualifikimi modern dhe të orientuar drejt botës së punës u mbledhën për të diskutuar se si mund të zbatohet bashkëpunimi midis teorisë dhe praktikës, midis biznesit dhe shkollave ose midis strukturave shtetërore dhe përfaqësuesve të ekonomisë.

GIZ, punon prej më shumë se 10 vjetësh në fushën e arsimit profesional. Përveç kontributit të saj në fushën politike shqiptare për futjen e sistemit të arsimit profesional dual, ajo nxiti elementët dual në kualifikimin profesional në nivel shkollë, si në shkollën profesionale në Kamëz, në veçanti, në fushat e përkujdesjes për të moshuarit dhe IT-së. Njëkohësisht, GIZ ndihmoi në realizimin e projektit, të financuar nga Erasmus +, “**Apprenticeship for Youth Employability**”, në kuadër të të cilit AKAFPK, me mbështetjen e institutit të Hamburgut për arsimin profesional, testoi një sistem dual në sektorin e hotelarisë dhe turizmit dhe zhvilloi një plan për një prezantim të përgjithshëm të kualifikimit dual.

Çfarë e karakterizon sistemin dual në përgjithësi? Ai karakterizohet nga bashkëpunimi i ngushtë midis shkollës dhe ndërmarrjes dhe njëkohësisht nga integrimi i komponentëve teorikë dhe praktikë të kualifikimit. Të mësuarit të vendi i punës në ndërmarrje u hap kursantëve më vonë dyert për një kalim të suksesshëm në tregun e punës. Kompanitë kualifikojnë të rinjtë sipas nevojave të tyre specifike. Nga ky bashkëpunim përfitojnë të dyja palët, punëdhënësit, të cilët do të kenë fuqi punëtore të kualifikuara dhe të rinjtë të cilët marrin një aftësim praktik, modern dhe të orientuar drejt nevojave të së ardhmes me të cilin mund të prezantohen në tregun e punës. Në nivel politik bashkëpunimi mes sektorit privat, shkollës dhe politikave arsimore dhe ekonomike, mundëson një përgjegjshmëri të përbashkët për kualifikimin profesional. Në fund është vetë vendi ai që përfiton, i cili nëpërmjet fuqisë punëtore të kualifikuara më mirë, bëhet më tërheqës për investitorët me vlerë të shtuar.

Nga shumë biseda me investitorë potencialë vazhdimisht bëhet e qartë se në të shumtën e rasteve ata kërkojnë më kot fuqi punëtore të kualifikuara. Ndodh kështu se ata kanë nevojë për fuqi punëtore të kualifikuara (**me përvojë pune**) për fushën jo-akademike, por, njëkohësisht edhe specialistë për fushën akademike. Kjo duke filluar me specialistët në administratë dhe zanatçinjtë, duke vazhduar me përpunuesit e metalit dhe deri tek inxhinierët dhe ekspertët me kualifikime ndërdisiplinare siç nevojiten në sektorin e elektronikës ose IT-së. Por ata, ende, gjejnë në tregun e punës në Shqipëri kryesisht juristë, gazetarë, politologë ose edhe ekonomistë. Është fakt që oferta për fuqi punëtore në Shqipëri dhe kërkesa e investitorëve ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra! Në shumë fusha të ekonomisë shqiptare ka potenciale të konsiderueshme zhvillimi dhe rritjeje. Në sektorët që sigurojnë rritje bëjnë pjesë: energjia e pastër, riciklimi, ujërat dhe kanalizimet, turizmi, bujqësia dhe industrinë



Anette Kasten



Sabine Hartig



Frank Hantke

e tyre përpunuese, sektorët ekzistues të industrisë së lehtë si edhe anekse të pashfrytëzuara dhe inovative, të cilat ende mund të zhvillohen.

Punëdhënësit modernë e dinë që sa më e mirë të jetë cilësia e produkteve dhe shërbimeve aq më i lartë do jetë fitimi. Këtë e dëshmon shembulli mbresëlënës i Gjermanisë, stabiliteti ekonomik i së cilës mbështetet kryesisht në dy shtylla të forta, nga njëra anë, fuqia punëtore e kualifikuar në fushën jo-akademike dhe nga ana tjetër fuqia punëtore po aq e kualifikuar në fushën akademike. Aftësia e zhvillimit të ekonomisë bazohet në bashkëveprimin harmonik dhe të balancuar të të dy fushave të kompetencës.

Në konferencën e organizuar më 3 nëntor 2015 sipërmarrës të përzgjedhur në Shqipëri prezantuan eksperiencat e tyre pozitive me kualifikimin modern dual të bazuar në teori dhe në praktikë. Kështu, ata dhanë një shembull mbresëlënës për kompanitë dhe sektorët e tjerë në vend. U diskutua se si mund të përmirësohet kuadri i përgjithshëm i arsimit dhe i praktikës profesionale në mënyrë që shembuj të tillë të mund të ndiqen edhe nga të tjerë.

Sigurisht që, së pari, partner kontakti në lidhje me temën e arsimit profesional është rinia. Duke krahasuar strukturat e moshës në vendet e BE-së, Shqipëria është në një situatë komode, sepse ajo ka një popullsi të re dhe me vullnet për të mësuar. Duke qenë e tillë ajo ka një potencial të konsiderueshëm për rritje ekonomike, si nga ana sasiore ashtu dhe cilësore. Megjithatë, vendi ka një papunësi ekstremisht të lartë të të rinjve, e cila është pjesërisht po aq e lartë sa disa vite më parë, madje edhe në rritje. Nuk duhet anashkaluar fakti që një pjesë e madhe e brezit të ri ka humbur shpresën për një të ardhme të mirë në vend.

Prandaj, ajo që duhet të kërkojmë nga njëra anë, është si të kënaqim nevojat e një ekonomie moderne të orientuar drejt BE-së dhe, nga ana tjetër, si të mund të ulim papunësinë e të rinjve. Perspektiva më të mira janë të mundshme nëpërmjet një rishqyrtimi themelor. Për këtë nevojitet bashkëpunim mes politikës, ekonomisë, shkollës dhe universitetit, por edhe midis të rinjve dhe prindërve të tyre. Edhe ekspertët e huaj mund të punojnë bashkarisht me vendimmarrësit dhe aktorët në „Modelin ekonomik dhe social të Shqipërisë“. Ky model të rinjve në zonat rurale u jep shpresë, ndërsa të rinjve të qytetit u ofron alternativa tërheqëse në vend të degëve të studimit jo tërheqëse dhe pa perspektivë. Gjithashtu kjo krijon lidhjen mes arsimit profesional dhe programeve mësimore akademike.

Ky do të ishte një model për një arsim të orientuar drejt profesionit, për të cilin politika dhe ekonomia mund të promovojnë së bashku! E rëndësishme është që të rinjtë të kualifikohen dhe të përsosin kompetencat dhe aftësitë e tyre për një sistem arsimor sa më të mirë. Këtu qëndron dhe përgjegjësia e brezit drejtues ndaj atij të ardhshëm. Një model i tillë gjithashtu do të dëshmojë që kjo është rruga e duhur për Shqipërinë drejt Bashkimi Evropian.

Kjo broshurë mbi konferencën synon të pasqyrojë diskutimet dhe rezultatet më të rëndësishme. Ajo gjithashtu duhet të shërbejë edhe si nxitje për rritjen e kërkesave ndaj ekspertëve dhe praktikantëve, për një angazhim në jetën e përditshme për ngritjen e vendeve të praktikës në ndërmarrje dhe për bashkëpunimin mes shkollave dhe ndërmarrjeve ose edhe për guximin për të zhvilluar degë kualifikimi dhe çertifikata të reja. Gjithashtu ajo duhet të bindë edhe prindërit dhe fëmijët e tyre që një kualifikim profesional i qëndrueshëm, më shpesh se ç'mund të mendohet, çon në një situatë të qëndrueshme të punës dhe të familjes në të ardhmen.

Programi

Regjistrimi dhe Kafë

Mirëseardhja

Znj. Etleva Sakajeva, Menaxhere e Përgjithshme, Parku i Biznesit Tiranë, Grupi Lindner

Hyrje

Znj. Sabine Hartig, GIZ - Znj. Anette Kasten, DIHA - Z. Frank Hantke, FES

Punësimi ka nevojë për Aftësi – Ekonomia ka nevojë për Punësim

Shkëlqesia e tij Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë

Formimi Profesional dhe Aftësitë e Mira si Shtylla Kryesore e një Ekonomie të Suksesshme

Shkëlqesia e tij Z. Hellmut Hoffmann, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë

Nevojat e përgjithshme të një ekonomie të zhvilluar – Balancimi i Aftësive Akademike dhe Jo - akademike

Z. Jürgen Hollstein, Drejtor Ekzekutiv (CEO), Organizata Gjermane e Punëdhënësve për Formim Profesional dhe Formim të Mëtejshëm

Diskutim në Panel

Si të përshtasim Nevojat e Biznesit dhe Aftësitë e Orientuara drejt Punësimit të të rinjve

- *Z. Arben Ahmetaj, Ministër për Zhvillimin Ekonomik, Turizmin, Tregtinë dhe Sipërmarrjen*
- *Z. Blendi Klosi, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë*
- *Z. Jürgen Hollstein, Drejtor Ekzekutiv (CEO), Organizata Gjermane e Punëdhënësve për Formim Profesional dhe Formim të Mëtejshëm*

Moderator: Z. Ardian Hackaj, Drejtor i ShtetiWeb

Pushim për kafë

Prezantimi i Grupeve të Punës

Znj. Sabine Hartig, GIZ

Grupet e Punës:

Ndërtimi & Infrastruktura	Industria Tekstile & e Lehtë	Kujdesi Shëndetësor & Kujdesi për të Moshuarit	Turizmi
Moderimi: <i>Znj. Anette Kasten, DIHA</i>	Moderimi <i>Znj. Sonila Limaj, AKAFP</i>	Moderimi <i>Z. Skender Dule, SANUS</i>	Moderation: <i>Znj. Etleva Vertopi, GIZ</i>

Pushimi i Drekës & Tregu i Mundësive - Shembuj bashkëpunimit mes ofruesve të AFP dhe biznesit, pilotime, mundësi për të hyrë në tregun e punës, etj.

Prezantimi i Gjetjeve të Grupeve të Punës nga Raportuesit

- *Znj. Anette Kasten, DIHA*
- *Znj. Sonila Limaj, NAVETQU*
- *Z. Skender Dule, SANUS*
- *Znj. Etleva Vertopi, GIZ*

Analiza dhe Konkluzionet për Bashkëpunim të Mëtejshëm

Znj. Anette Kasten, DIHA

Komentet e fundit

Z. Frank Hantke, FES

Pritje e shoqëruar me një fjalim nga Znj. Dafina Peci, Presidente e Kongresit Kombëtar të Rinisë (KKR)

Formimi Profesional dhe Aftësitë e Mira si Shtylla Kryesore e një Ekonomie të Suksesshme



Z. Hellmut Hoffmann, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë

Jam i kënaqur të hedh një vështrim mbi trajnimin e formimit profesional. Në të vërtetë, kjo është një nga temat e mia të preferuara. Përse është kështu? Përgjigjia është e thjeshtë: unë jam i bindur se progresi ekonomik dhe social i një vendi varet në shumë mënyra nga disponueshmëria e një force të kualifikuar pune. Do ta argumentoj këtë me suksesin ekonomik të vendeve si Gjermania, Austria dhe Zvicra, që mund të shpjegohet kryesisht nga fakti se këto vende kanë një traditë të gjatë të një sistemi të mirë-zhvilluar të trajnimit profesional.

“Forcë pune e mirë-trajnuar” do të thotë: një gërshetim i mirë mes njerëzish të trajnuar në nivel akademik dhe në nivelin e trajnimit profesional, pra, persona të trajnuar në profesione të ndryshme, zanat dhe aftësi. Përshtypja ime është se ekonomia shqiptare ka nevojë për më shumë njerëz të cilët janë kompetentë për një gamë të gjerë të tregut, në zanat dhe aftësi, nga kamerierë, ndërtues, saldatorë, hidraulikë, mekanikë, elektrikistë, fermerë e punonjës të shëndetësisë, e deri në ekspertë në elektronikë, teknikë e ndihmës mjekë.

Duke thënë këtë, nxitoj të shtoj se: Të gjitha këto kompetenca duhet të jenë relevante për tregun e punës! Kjo është çështja kyc! Njerëzit duhet të trajnohen vetëm duke pasur një kuptim real të kërkesës së tregut të punës!

Ka gjithashtu dhe një element sociologjik që do të doja të shtoja: Përveç faktit se njerëzit e trajnuar performojnë më mirë duke krijuar më tepër mirëqënie, ata bëhen faktor për kohezion social dhe stabilitet politik nëpërmjet aftësive të tyre dhe rregullimit të tregut, pasi kërkojnë të kenë të ardhura më të mira se punëtorët (të punësuarit) e patrajnuar.

Gjatë 25 viteve të shkuara ka pasur një përqëndrim të madh drejt arsimit të lartë në Shqipëri. Unë jam koshient për sfondin politik dhe historik të këtij zhvillimi. Por gjithsesi duhet thënë se kjo nuk e ndihmoi mjaftueshëm Shqipërinë. Fakt është se kemi gjithë këta juristë dhe ekonomistë të diplomuar, në më shumë se 40 universitete private, kualiteti i të cilëve nuk është kontrolluar siç duhet e shpesh ka funksionuar si një ftesë për korrupsion flagrant. Në të njëjtën kohë, forca reale e ekonomisë, si psh njerëz me shprehje profesionale, pothuajse kanë qenë të injoruar. Do ta ilustroj me një shembull këtë. Më është thënë se përveç Universitetit të Kamzës, nuk ka asnjë institucion trajnues për agrikulturën në të gjithë vendin dhe mbi të gjitha, të diplomuarit e Universitetit të Kamzës si rregull nuk merren me bujqësi, por punojnë në kompani dhe në sektorin e biznesit. Kjo në fakt do të thotë se në fushën e agrikulturës, që në princip përbën një potencial në rritje në Shqipëri, nuk ka pothuajse asnjë mundësi për trajnim profesional sistematik për fermerët e ardhshëm.

Çfarë duhet bërë? A mundet një vend si Shqipëria të ndërtojë një sistem të trajnimit profesional? Po, mundet! Por kjo kërkon përkushtim të qëndrueshëm, të mirë-organizuar për një kohë të gjatë. Trajnimi profesional nuk është një fushë që mund të korrësh shpejt “shpërbllim politik”!

Është e rëndësishme të kuptojmë që sistemi i trajnimit profesional në shtetet gjermanisht-folëse bazohet në një traditë të vjetër shekullore e cila nuk mund të kopjohet kaq lehtë.

Gjithkush flet për përfshirjen e sistemit të trajnimit profesional “Dual” në Shqipëri. Çfarë nënkuptojmë me trajnimin profesional Dual?

Trajnimi profesional dual nënkupton një bashkëpunim shumë të ngushtë mes kompanive të sektorit privat, dhomave të tregëtisë dhe shkollave të trajnimit profesional. Në praktikë kjo nënkupton se kompanitë paguajnë nxënësit për rreth 2-3 vjet një rrogë minimale (e cila është më e ulët se rroga minimale e standartizuar, por gjithsesi përbën kosto financiare), ju mësojnë atyre pjesën praktikë të zanatit apo aftësive në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe shumë të organizuar, ndërkohë që i lejojnë ata të ndjekin shkollën për rreth një të tretën e kohës.

Le të jemi të sigurtë: sektori privat në Shqipëri nuk është gati për këtë, për një periudhë jo të shkurtër kohe. Maksimumi që ne mund të arrijmë në të ardhmen e parashikueshme është të rrisim interesin e disa kompanive të sektorit të biznesit që janë të gatshme të bashkëpunojnë me shkollat profesionale, t’ju ofrojnë praktika dhe të rekrutojnë të diplomuarit të cilët janë më të shtrenjtë përse i përket rrogave. Nëse kjo duhet të quhet sistem

i trajnimit profesional dual, kjo është një çështje tjetër, që nuk lidhet drejtpërdrejtë me temën tonë.

Atëherë çfarë duhet të bëjmë?

Në opinionin tim, i vetmi opsion real është të krijojmë një sistem kombëtar të shkollave të trajnimit profesional të cilat ofrojnë teori dhe trajnime praktike dhe të afrojmë me to sa më shumë kompani që të bashkëpunojnë me këto shkolla.

Ndoshta ky propozim do të duket i parëndësishëm në pamje të parë, por në fakt nuk është kështu, pasi është e mirë-ditur edhe pse nuk flitet shumë për këtë në Shqipëri, se në shkollat profesionale në Shqipëri pjesa praktike si zanati, puna dhe shprehitë mësohen vetëm nëpërmjet librave shkollorë dhe dërrasës së zezë. Për të krijuar një imazh, nxënësit nuk kanë një kaçavidë në duart e tyre, por shohin vetëm një vizatim të saj në dërrasë e zezë!

Atëherë, si mund të ndërtohet një sistem efektiv i trajnimit profesional?

Si fillim duhet të bëhet e qartë se kush është përgjegjës për këtë. Nevojitet një skuadër kompetente e punonjësve të administratës publike e cila qëndron në punë edhe pasi ndërrohen qeveritë apo ministrat për të mundësuar vazhdueshmërinë në implementimin e qëndrueshëm të politikave.

Së dyti: nevojitet një plan i qartë apo strategji. Duhet të ketë qartësi për pyetje të tilla si psh, sa shkolla duhet të ketë në secilin qytet, çfarë lëndësh duhet të ofrohen në linjë me kërkesat e tregut në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal; duhet të jetë e qartë se çfarë kurrikule, materiali mësimor dhe pajisjesh teknike kërkohen, cilët mësues dhe çfarë trajnimi kanë ata, kriteret pranuese në shkolla dhe kriteret për diplomim. Dhe së fundmi është e rëndësishme që studentët të mos abuzojnë me sistemin e trajnimit profesional si një alternativë e thjeshtë krahasuar me shkollat e tjera për t'u pranuar në universitet (si në rastin e pothuajse gjysmës së të diplomuarve, që mund të konsiderohet si shpërdorim i parasë).

Pa dyshim ka shumë çështje dhe tema që duhet të sqarohen, të zgjidhen dhe të vendosen, por me siguri mund të thuhet se nuk është si të shpikësh raketa për të zhvilluar një sistem efektiv të trajnimit profesional.

Me qëllim përdor termin “sistem” pasi ai është i një rëndësie të lartë. Dhe me këtë më lejon të shtoj dhe mendimet e mëposhtme. Askush nuk ka nevojë të “shpikë rrotën” çdo dy vjet! E them këtë sepse ka një rrezik në vendet me burokraci të dobët dhe përballen me një variacion të madh donatorësh të cilët janë gjithmonë në kërkim të “mundësive për investim” që të flitet për programet dhe fondet e tyre dhe që nuk kanë një koncept të ri dhe në harmoni, dhe mbi të gjitha me konsulentë të cilët janë të interesuar të zbatojnë konsulentat e tyre. Në këtë mënyrë asnjë sistem real nuk mund të zhvillohet, por thjesht një koleksion zgjidhjesh të izoluar, të cilat reflektojnë kryesisht preferencat e donatorëve të ndryshëm.

Një numër i rëndësishëm i partnerëve ndërkombëtarë kanë mbështetur për shumë vite ndërtimin e trajnimit profesional në Shqipëri. GIZ ka mundësuar ekspertiza afatgjata dhe vazhdon ta bëjë këtë. Në 2014 ka prodhuar një studim prej 110 faqesh mbi situatën e trajnimit profesional në Shqipëri; gjithashtu GIZ mbështet dy subjekte të qëndrës profesionale në Kamëz.

Lidhur me këtë do të doja të theksoja një çështje thelbësore: është shteti shqiptar i cili ka për detyrë dhe është përgjegjës për sistemin e trajnimit profesional në vend, duke përfshirë edhe planifikimin e buxhetit! Brenda parametrave të qartë të cilat janë të përcaktuar nga shteti, donatorët duhet të krijojnë profilin e tyre në shkollat ku janë të përfshirë. Kjo do të ndihmojë për ta bërë më atraktiv trajnimin profesional dhe do të ndërtojë një marrëdhënie të nevojshme me kompanitë kombëtare apo nga vendet që përfaqësojnë donatorët.

Në përfundim: për të krijuar një sistem të suksesshëm të trajnimit profesional nevojitet vizioni si më poshtë:

- Orientim i vazhdueshëm, afatgjatë dhe i mirë-informuar nga qeveria,
- Koordinim i vazhdueshëm mes qeverisë dhe donatorëve të përfshirë në nivel operacional dhe praktik,
- Bashkëpunim të qëndrueshëm me kompanitë e sektorit privat,
- dhe mbi të gjitha, *vazhdimësi!*

Jam i bindur se nëse qasja do të jetë e tillë, sistemi i trajnimit profesional efektiv në Shqipëri, mund të ndërtohet!

“Profesionet më të kërkuara”

Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë



Në thuajse çerek shekulli tranzicion, ne humbëm tërësisht shqisën apo e mpimë tërësisht shqisën e zanateve dhe e transformuam të gjithë rrugën e investimit në dije, në një rrugë me një korsi të vetme, që ishte korsa e arsimit të lartë. Bëmë gjithçka mundëm për të ndërtuar një piramidë iluzionesh, duke iu krijuar praktikisht, të gjithë të rinjve dhe po ashtu, edhe prindërve, idenë se çdokush mund të bëhej jurist, ekonomist apo inxhinier dhe se ishte ikur koha kur njerëzit mund të jetonin me “ambicien e vogël” të të qenit zejtar apo të të pasurit të një zanati.

Sidoqoftë ka gjithmonë një moment për të filluar dhe ne kemi filluar duke çelur korsinë alternative të zanateve, për gjithë ata të rinj që për arsye nga më të ndryshmet nuk ndjekin universitetin

Është një sistem që do të kërkojë kohën e vet. Gjithsesi, ne e kemi filluar këtë proces e shenjat e para janë inkurajuese. Është inkurajues fakti, që vitin e parë pas reformës është dyfishuar numri i vajzave dhe i djemve që janë regjistruar në shkolla profesionale. Po ashtu është inkurajues fakti, që në statistika e atyre që marrin një punë, ata të cilët kanë mbaruar një shkollë profesionale, janë pothuajse njësoj të kërkuar si ata që kanë universitetin.

Sigurisht që për të ndërtuar një arsim profesional të besueshëm na duhet të bëjmë gjithçka nga e para, sepse ai që quhej arsim profesional në Shqipëri ishte një sistem i marrë fund klasash.

Ndërkohë që sistemi dual, të cilit ne i jemi referuar në këtë reformë, është ambicia për të lidhur nxënësin me tregun, qysh sapo fillon të mësojë zanatin dhe për t'i dhënë mundësi kompanive që t'i referohen shkollave profesionale, për të rekrutuar qysh në fillim të shkollës zanaçinjtë e tyre të nesërm, duke e ndarë kohën mes shkollës dhe punës në ndërmarrje, gjatë çdo jave.

Shkollat profesionale janë një urë solide për punësim dhe perspektivë të qartë përmes një karriere të sigurt, gjë që nuk mund të thuhet për arsimin e përgjithshëm, por as për universitetin. Garancia e këtij sistemi janë kompanitë, jo mësuesit në klasë.

Sigurisht që ka ende një rrugë të gjatë për të bërë. Vizioni tani më është shumë më i qartë dhe ideja për të ndërtuar një rrjet shkollash profesionale të ekselencës, në bashkëpunim me një numër donatorësh të përzgjedhur, jo pse kanë para, por pse kanë dijen e nevojshme, nga Gjermania, tek Austria e Zvicra, është një ide fituese për t'ju dhënë një mesazh dhe një rrugë shumë të qartë, të gjithë atyre fëmijëve që hynë në arsimin profesional dhe të gjithë atyre prindërve që investohen për fëmijët e tyre, të cilët nuk ka pse të ndjehen inferiorë ndaj komshinjve prindër, që investojnë për t'i bërë fëmijët juristë apo sociologë.

Ko është një fazë e ndërmjetme që do të kërkojë kohën e vet, me parakushtin që ne të forcojmë në mënyrë të vazhdueshme dy komponentë, konkurrencën dhe meritën. Shumë më e lehtë ta thuash, shumë më e vështirë ta bësh, por sot, në administratën publike të shtetit shqiptar nuk hyn dot më kollaj. Për çdo vend në administratën publike zhvillohen konkurse dhe ka një fakt që hedh poshtë çdo lloj nihilizmi apo abuzimi, kemi sipas sektorëve, në mesatare, mbi 20% të konkurseve që dështojnë, pra, nuk kanë fitues. Ka pjesë në administratë ku konkurset kanë edhe 50% dështim, sepse nuk nxjerrin fitues. Kuptohet që një konkurs mesatarisht cilësor nuk fitohet dot, nëse diplomën e ke marrë me lekë. Unë besoj që forcimi i kësaj hallke, - nuk është perfekte, është larg të qenit perfekte, por është hallka e duhur që do të forcojmë, - do të çlirojë shumë më tepër energji në drejtim të sektorit privat dhe do të çlirojë shumë më tepër energji në drejtim të dijes, që njerëzit të kuptojnë se duhet të përgatiten për të marrë një vend pune.

E nuk ka fatkeqësi më të madhe për një komb, për një popull, për një vend, sesa kur ata që e drejtojnë janë të varfër në aspirata. Të varfër në aspirata për vendin, se për veten e tyre mund të kenë aspirata të mëdha.

Jemi në drejtimin e duhur, por padyshim do të na duhet shumë këmbëngulje, shumë përpjekje dhe shumë durim. Përndryshe nuk ka asnjë stacion tjetër, përveçse të kthehemi mbrapa.

Sfida që kemi zgjedhur është shumë e madhe, se kemi zgjedhur të marrim modelin gjerman, por modelin gjerman pa gjermanë, me shqiptarë. Në fund të fundit ka një fakt të thjeshtë dhe të mjaftueshëm për të mos u dorëzuar, nëse shqiptarët në Gjermani do të kishin dalë të paaftë, atëherë, ne mund t'i thoshim vetes se s'kemi pse përpiqemi të bëhemi si Gjermania, apo s'kemi pse të marrim shembuj gjermanë. Por shqiptarët në Gjermani nuk kanë rezultuar të paaftë. Kanë rezultuar të suksesshëm, janë integruar, punojnë në të gjitha nivelet, sipas aftësive dhe sipas mundësive dhe nuk kanë lënë vend për t'u parë me syrin e një populli të veçantë, që nuk e njih punën, që nuk e do punën, që nuk e kupton punën.

Ajo që ne kemi fatin sot si vend, jo për t'u ngushëlluar, është se nuk kemi asgjë për të shpikur. Modelet janë aty, miqtë i kemi këtu, partnerët janë të gatshëm të na ndihmojnë për të ndërtuar sisteme.

Edhe një herë tjetër mirënjohje miqve gjermanë, që me shumë gatishmëri na asistojnë në këtë reformë dhe që e kam vënë re që kur vijnë në Shqipëri, duan të vijnë prapë e prapë. Shpresoj të vini aq sa duhet, që të mos bëheni si ne, përpara se ne të bëhemi si ju.

Si të përshtasim Nevojat e Biznesit dhe Aftësitë e Orientuara drejt Punësimit të të rinjve?

Arben Ahmetaj,

Ministër për Zhvillimin Ekonomik, Turizmin, Tregtinë dhe Sipërmarrjen



Arsimi profesional gjithnjë e më shumë po bëhet një kërkesë imperative e kohës, që ti përgjigjet në mënyrë adekuate sfidave që përjeton sot e gjithë bota: *konkurrenca globale; numrit të lartë të punëtorëve me nivel të ulët kualifikimi, papunësisë së rinisë dhe plakjes së popullsisë.*

Është kjo arsyeja që strategjia e BE-së deri në vitin 2020, e konsideron si objektiv parësor edukimin për sipërmarrjen dhe trajnimin, si kusht që mbështet rritjen dhe krijimin e bizneseve të reja.

Të investosh në edukimin për sipërmarrjen, BE-ja e konsideron investimin më të zgjuar dhe rikthimi më i lartë i këtij investimi.

Tashmë kur tregu shqiptar gjithnjë e më shumë po bëhet pjesë e tregut global, nëpërmjet diversifikimit të eksporteve apo dhe investimeve të huaja, përveç kostos së ulët të fuqisë punëtore bëhet më imperative rritja e nivelit të njohurive lidhur me nevojën e investimeve në teknologji, nevoja për të intensifikuar masat e ndërmarra nga qeveria, për të mbështetur dhe forcuar cilësinë e shërbimeve ndaj biznesit dhe forcimin e kapaciteteve teknike dhe menaxheriale të kompanive.

Qeveria shqiptare është futur në një fazë tepër të rëndësishme lidhur me masat për përmirësimin e klimës së biznesit dhe të reduktimit të barrierave administrative. Kohët e fundit është miratuar një paketë e rëndësishme masash ligjore, si ligji për investimet strategjike, për zhvillimin e zonave ekonomike, turizmin dhe partneritetin publik-privat. Kjo do të thotë se bazuar në prioritetet e sektorëve strategjikë, qeveria duhet të fokusohet shumë më tepër në rritjen e aftësive profesionale dhe menaxheriale të këtyre sektorëve si bujqësia, turizmi, energjia, transporti, zonat ekonomike etj., ku investitorët qofshin të huaj dhe vendas presin të gjejnë një fuqi punëtore të kualifikuar.

Të përgatisësh punëtorët për të konkuruar bazuar në dijet që marrin në ekonomi, kërkon një model të ri të edukimit dhe trajnimit, një model i ashtquajtur të mësuarit gjatë gjithë jetës që mban gjallë dhe të angazhuar me ndryshimet e fundit në teknologjitë e avancuara.

Në të kaluarën, studentët shkonin në shkollë, merrnin diplomën përkatëse dhe punonin në sektorët e ndryshëm të industrisë. Kjo ka funksionuar për një periudhë të gjatë kohe, pasi njohuritë që kishin fituar në shkollë ishin akoma të vlefshme. Por kohët kanë ndryshuar, në një treg global, ku konkurrenca është tepër e ashpër, shpejtësia e ndryshimit të ekonomisë së dijes është tepër dinamike, çdo nivel kualifikimi zhvlerësohet me kohën.

Përveç përpjekjeve nga ana e kompanive, marrja e njohurive duhet të mbështetet edhe nga institucionet e trajnimit për të përgatitur punonjësit / punëtorët për të mësuarin gjatë gjithë jetës.

Rol për këtë ka luajtur AIDA-s, DHTI, ARZH, shoqata të ndryshme biznesi, programet e trajnimit të donatorëve si GIZ, USAID, PNUD, BERZH/ BAS, kooperacioni Italian, Zvicëran, etj.

Në strategjinë e ZHBI 2014-2020 një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të sektorit privat është të mësuarit për sipërmarrjen.

Projekte që mbështesin të mësuarit për sipërmarrjen:

- Plane biznesi konkurruese nxitëse: mbështet të rinj me ide inovative nëpërmjet planeve konkurruese biznesi. Këtij qëllimi i shërben edhe fondi grant i qeverisë, i cili disbursohet nga AIDA, ku bizneset fillestare mund të përfitojnë grante deri në 300 mijë lekë.

- Me projektin rajonal të Qendrës së të mësuarit për sipërmarrjen, SEECEL janë pilotuar të mësuarit për sipërmarrjen në 6 insitucione arsimore.

Një nga prioritetet e zhvillimit afatgjatë të sektorit të SME-ve, është nxitja e kulturës së sipërmarrjes, edukimit dhe trainimit të tyre.

-Synohet që të inkurajohen universitetet që të ofrojnë kurse të specializuara mbi sipërmarrjen në fusha të tilla si e-bussines, teknologjitë e inovacionit etj.

-Për të nxitur zhvillimin e sipërmarrjes kreative, me qëllim rritjen e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme dhe krijimin e vendeve të punës në sektorin e artizanatit, qeveria po kontribuon me Fondin Grant të Ekonomisë Kreative, kryesisht për artizanatin, me qëllim: zhvillimin e produktit; marketingun; si dhe kualifikimin dhe ndërtimin e kapaciteteve që përfaqësojnë këtë sektor.

Për të nxitur kompanitë që të punësojnë të rinjë të kualifikuar sipas nevojave të tregut të punës, qeveria është e interesuar të ndërmarrë politika ndihmuese të tilla si:

- marrja përsipër nga shteti të mbulimit të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore për 3 vitet e para;
- Bizneset të pranojnë për praktikë 1-3 mujore nxënës e studentë ku shteti të mbulojë përsëri kontributin e sigurimeve shoqërore gjatë periudhës së praktikës.

TIK është një ndër instrumentat kryesor që shërben për rritjen ekonomike dhe në vecanti për një rritje më të shpejtë të SME-ve. Mbështetur edhe në axhendën dixhitale dhe të iniciativave flagship të politikës industriale të BE-së, fokusi qëndron në: *shfrytëzimin maksimal të potencialeve që ofron TIK, si në fushën e ofertës, për produkte dhe shërbime të reja dixhitale, ashtu edhe në anën e kërkesës, për një përdorim të zgjuar (smart) të këtyre teknologjive*. Duke ditur se tregu shqiptar është pjesë e kërkesës, investimi në teknologjinë dixhitale është e vetmja zgjidhje, ku çdo SME mund të bëhet konkurreuese. Nga ana tjetër kjo konsiderohet për biznesin si një mundësi dhe njëkohësisht sfidë, pasi bizneset e vogla janë më pak të pajisur dhe i nevojitet kohë dhe kapital financiar për aplikimin e këtyre modeleve të reja të biznesit.

-Puna do të fokusohet në fuqizimin dhe mbështetjen e bizneseve fillestare start-ups për shërbime dixhitale, ëeb dhe për alternativa në mbështetje financiare, sic janë skemat “innovation voucher”; për të garantuar një përdorim sa më të mirë të fondeve Europiane, si pjesëmarrja në COSME/EEN.

Një rëndësi të madhe merr përmirësimi dhe shtimi i shërbimeve ndaj biznesit, nëpërmjet plotësimit dhe fuqizimit të portalit për SME-të, si dhe rrjetit me qendrat e informimit të biznesit; Kryerja çdo dy vjet e analizës së nevojave për trajnime për biznesin, menaxhimi i skemave të financimit për inovacionin, përmirësimi i shërbimeve online për trajnime, pagesa, informacione etj, janë masa që ndikojnë në zhvillimin e kualifikimit të vetë biznesit, e bëjnë atë më të ndërgjegjshëm dhe më kërkues ndaj sistemit formal të edukimit dhe për ta konsideruar këtë të fundit si një ofertë shumë atraktive që ndikon në rritjen e konkureshmërisë së vetë kompanive.

Si të përshtasim Nevojat e Biznesit dhe Aftësitë e Orientuara drejt Punësimit të të rinjve?



Blendi Klosi,

Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë

Papunësia është problemi më i madh me të cilin jemi përballur ne shqiptarët gjatë këtyre dy dekadave të fundit. Sot jetojmë në një kohë kur ndryshimet në ekonominë botërore janë me ritme shumë të shpejta. Efekti i këtyre ndryshimeve në tregun e punës mund të sjellë përfitime të mëdha por në anën tjetër edhe probleme të panumërta siç është edhe problemi i papunësisë apo dhe përjashtimi social i individëve.

Globalizimi, teknologjia informative dhe ndryshimet në organizimin e punës kanë krijuar një kombinim që ka shtuar kërkesën për profesioniste, teknike dhe fuqi punëtore të kualifikuar. Disa profesione të vjetra janë zhdukur ndërkohë janë shfaqur profesione të reja, duke bërë të nevojshëm identifikimin e këtyre profesioneve në treg dhe klasifikimin e tyre. Këtu ndikojnë dhe forcat globale për ndryshime që janë konkurrenca globale dhe teknologjia informative. Liberalizmi ekonomik dhe konkurrenca globale kanë shtuar fleksibilitetin e tregut të punës. Fleksibiliteti mund të ketë forma të ndryshme. Ai mund të ndikojë në paga, në numrin e punëmarrësve, në funksione, në aftësitë e kërkuara dhe në lëvizjen gjeografike.

Efekti i papunësisë së lartë ndikon më shumë tek të rinjtë, të moshuarit, më pak të kualifikuarit dhe grupe të tjera të veçanta. Niveli i lartë i papunësisë jo vetëm presupozon rritjen e numrit të përfituesve nga skemat e mbështetjes me të ardhura, por shkakton dhe rritjen e numrit të atyre të cilët nuk i plotësojnë detyrimet për kërkimin e një vendi pune.

Pabarazia dhe mospërfshirja sociale shkaktohet pjesërisht nga papunësia e lartë e cila i mban njerëzit për një kohë të gjatë në kushte të mospërfshirjes sociale dhe të varfërisë.

Ekziston një shkallë e lartë e përjashtimit nga tregu i punës, sidomos për grupet situacionale të popullsisë: rininë, gratë dhe punëtorët e pakualifikuar. Gjatë vitit 2014 papunësia rinore (grup-mosha 15-29 vjec) ka qenë 32.5%, kundrejt 17.9% të nivelit zyrtar të papunësisë. Papunësia tek të rinjtë lidhet me mungesën e mundësive të reja për punësim në sektorin publik dhe hezitimin e sektorit privat për të punësuar moshat e reja.

Papunësia e gjatë riprodhon në mënyrë ciklike punëtorë të dekurajuar, të cilët tentojnë të shndërrohen në një barrë për sistemin e mirëqenies. Në vitin 2014 numri i të papunëve afatgjatë ishte rreth 12 herë më i madh se numri i të papunëve që përfitonin pagesë papunësie, 82,133 kundrejt 7,395.

Punëkërkuesit e papunë të rregjistruar janë 152 mijë dhe nga këta rreth 50% përfitojnë nga skemat e mbështetjes me të ardhura, ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie. Interesimi i këtyre grupeve për t'u punësuar në programet e ofruara nga zyrat e punësimit është tepër i ulët gjë që të bën të mendosh se ky grup nuk është realisht i interesuar për të gjetur një punë por thjesht për të përfituar nga skemat e mbështetjes me të ardhura. Në programet e nxitjes së punësimit për vitin 2015 megjithë përpjekjet e shërbimeve të punësimit vetëm 7% të të punësuarve në këto programe janë përfitues të ndihmës ekonomike.

Për t'iu përgjigjur kësaj Ministria ka hartuar dhe miratuar në parim në Këshillin Kombëtar të Punës një projektligj "Për punëkërkuesit e papunë", projektligj i cili synon të rregullojë procesin e vlerësimit të tyre. Me anë të këtij projektligji Ministria synon të ndryshojë raportin midis atyre që duan të punojnë në punë të denjë me ata që duan të marrin vetëm ndihmën ekonomike apo asistencën sociale.

Ka mbizotëruar për një kohë të gjatë fragmentimi midis nevojave të tregut të punës dhe sistemit të arsimit dhe formimit profesional.

Problematikat e këtij sistemi janë të shumta por unë po ndalem vetëm te disa prej tyre.

- i) Sistemi i AFP ishte i vjetëruar, jashtë kohës dhe i pafuqishëm për të ndihmuar rihyrjen në treg të fuqisë punëtore jashtë tregut.

- ii) Shkalla e punësimit të të formuarve në sistemin publik ka qenë dhe mbetet shumë e ulët, më pak se 20%, dmth 3-4 herë më e ulët se mesatarja e BE-së.
- iii) Sistemi i AFP ka qenë konceptuar si një sistem publik, i mbështetur vetëm nga financime publike. Sipërmarrja private e konsideronte mbështetjen me burime financimi të sistemit të AFP një barrë dhe jo një investim.
- iv) Konkurenca midis sistemit publik dhe privat të AFP-së ka qenë inekzistente.
- v) Tregu i punës mbetet refraktar e joelastik edhe ndaj të rinjve që shkollohen. Përfundimi i shkollave të mesme dhe të larta dhe kërkesat në rritje për punësim nga ky kontigjent nuk gjejnë përgjigjen e duhur nga kapacitetet thithëse të tregut të punës. Kjo dukuri rrit numrin e të papunëve të diplomuar.
- vi) Vetë sistemi i arsimit profesional dhe sistemi i formimit profesional ishin në një mungesë të theksuar sinergjie, komunikimi e plotësimi të njeri-tjetrit.

Kjo gjendje na detyroi të fillojmë të rindërtojmë nga e para sistemin e arsimit dhe formimit profesional.

Reformimi i sistemit të arsimit dhe Formimit Profesional për prodhimin e profesionistëve që mund të akreditohen nga sistemi i shkollave profesionale të BE-së duke i bërë konkurentë në tregun e punës, nëpërmjet krijimit të shkollave profesionale të ekselencës.

Një karakteristike e tregut të punës në Shqipëri është dhe niveli shumë i lartë i punësimit informal, i cili ushqehet nga disa rrethana:

Niveli i lartë i ekonomisë informale; punëtorët nganjëherë pranojnë të punojnë në sektorin informal të detyruar nga mungesa e alternativave për t'u punësuar në sektorin formal; sipërmarrja e konsideron informalitetin si një zgjidhje që ofron një mjedis më të mirë; një pjesë e të punësuarve në sektorin informal nuk u japin shumë rëndësi përfitimeve dhe mbrojtjes sociale që ofrohen përmes instrumenteve formale ligjore dhe institucionale.

Ndër tiparet më të spikatura të informalitetit në tregun e punës mund të vlerësohen:

Niveli i lartë i informalitetit në sektorin modern, në krahasim me sektorin tradicional, bujqësinë; Diversiteti sektorial i informalitetit, me tendencë rritjeje në ndërtim e shërbime; Pasojat më të ndjeshme të informalitetit të të punësuarit me pagë; Niveli mjaft i ulët i pagave në sektorin informal krahasuar me sektorin formal; Diferencimi më i madh i pagave në sektorin informal në krahasim me sektorin formal; Evazoni dhe konfuzioni në raportimin dhe pagesën e taksave të punës; Ndikimet kontradiktore të dinamikës së pagës minimale në dinamikën e informalitetit.

Tiparet e mësipërme pengojnë ose ngadalësojnë krijimin e një ambjenti nxitës për rritjen e punësimit, rritjen e produktivitetit të punës dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së punonjësve informale.

Shkalla e lartë e informalitetit të punës dhe të ekonomisë e detyroi qeverinë të nisë betejën e ashpër me ushqyesit e informalitetit: politikë, kulturore, ekonomike, njerëzore etj.

Mungesa e sinergjisë midis politikave të punësimit dhe politikave të pensioneve.

Shkalla e lartë e informalitetit ushqente evazionin kontributiv dhe e kishte bërë skemën e pensioneve një skemë jokontributive, por rishpërndarëse të financimeve buxhetore. *Kjo na detyroi të ndërmerrim hapin e guximshëm të reformimit të skemës së pensioneve.*

Shpërndarja e pabarabartë e papunësisë

Nga perspektiva territoriale, papunësia vjen duke rënë nga zona veriore (Dibër, Kukës, Shkodër, Lezhë); në zonën qendrore (Durrës, Korçë, Berat, Elbasan) dhe në zonën jugore (Gjirokastrë, Vlorë, Fier). *Kjo situatë e ka detyruar qeverinë të programojë mbështetje prioritare për rajonet me papunësi më të lartë, si një rrugë për forcimin e kohezionit social dhe territorial të vendit.*

Si të përshtasim Nevojat e Biznesit dhe Aftësitë e Orientuara drejt Punësimit të të rinjve?

Jürgen Hollstein,

Drejtor Ekzekutiv (CEO), Organizata Gjermane e Punëdhënësve për Formim Profesional dhe Formim të Mëtejshëm



Arsimi profesional dhe modeli gjerman i „arsimit profesional dual“ kanë marrë prej disa kohësh një rëndësi që nuk pritej më parë dhe gëzojnë ndërkombëtarisht një reputacion të lartë. Faktorët vendimtarë për këtë sukses, sigurisht, janë cilësia e arsimit profesional në Gjermani, kalimet e suksesshme nga shkolla e përgjithshme në shkollën profesionale dhe nga shkolla profesionale në punë. Rezultat i kësaj është ulja e vazhdueshme e papunësisë në Evropë. Në Gjermani arsimi profesional nuk konsiderohet vetëm si komponent i rëndësishëm i konkurrencës dhe inovacionit të ekonomisë gjermane, por edhe si element kyç për kohezionin e shoqërisë.

Kontribut shumë të madh për këte jep përditësimi dhe modernizimi i vazhdueshëm i profesioneve duale, i filluar bashkarisht dhe në partneritet nga punëdhënësit dhe punëmarrësit. Profesione moderne dhe bashkëkohore sigurojnë nevojat e së ardhmes për fuqi punëtore të kualifikuar, duke garantuar një alternativë atraktive dhe të barazvlefshme me arsimin akademik. Pavarësisht sfidave të shumta (p.sh. zhvillimi demografik, mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar, prirja drejt arsimit akademik etj.), me të cilat duhet të përballet edhe praktika gjermane e arsimit profesional, modeli gjerman i arsimit profesional dual vazhdon të jetë tërheqës. Megjithatë, të gjitha palët e përfshira në të e kanë kuptuar se është e kotë të kopjojnë „modelin gjerman“ ose ta zbatojnë atë në mënyrë identike në një vend tjetër. Traditat, e krijuara pjesërisht prej shekujsh, strukturat e qëndrueshme si dhe bashkëpunimi i provuar dhe i besueshëm i partnerëve social krijojnë kushte unike, të cilat nuk duhet të transferohen sipas „metodës copy-and-paste“. Përkundrazi, e rëndësishme është të identifikohen dhe të fuqizohen strukturat duale ekzistuese në vend.

Deri tani interesi në modelin e arsimit profesional dual ka pësuar edhe zhgënjimin e parë, kur është bërë e qartë që përgjegjësia për arsimin profesional nuk vazhdon të jetë (më) vetëm e shtetit, por në masë të konsiderueshme e partnerëve social. Financimi i arsimit profesional do të zhvendoset kryesisht te kompanitë. Ky element thelbësor i modelit gjerman kërkon një rishqyrtim nga të gjithë palët e përfshira.

Shkollat profesionale vazhdojnë të kenë një rol të rëndësishëm në procesin arsimor, por atyre u duhet të koordinohen me kompanitë trajnuese dhe të përfshihen në dialog, i cili për disa palë të përfshira. është disi i pazakontë.

Kompanitë duhet të kuptojnë që angazhimi në arsimin profesional ka kosto të caktuara si nga ana organizative, ajo e personelit ashtu dhe nga ana financiare. Ky arsim është një investim për të ardhmen dhe rezultatet nuk mund të priten brenda një kohe të shkurtër. Por, „përfitimet“ në terma afatmesëm dhe afatgjatë janë të mëdha. Një element thelbësor në modelin e arsimit dual është fakti që, praktikantët nuk janë nxënës por punonjës të kompanisë përkatëse, të cilët sigurisht kanë jo vetëm një **kontratë** kualifikimi por edhe të drejtën për të marrë **pagë** kualifikimi. Shpenzimet e drejtpërdrejta të personelit për praktikantët përbëjnë 60% të shpenzimeve të trajnimit, 25% e shpenzimeve të tjera shkojnë për stafin trajnues dhe pjesa e mbetur për materiale trajnimi, tarifa etj.

Njëkohësisht duhet patur parasysh fakti që me rritjen e kohëzgjatjes së trajnimit rriten edhe përfitimet e kompanisë ku kryhet trajnimi. Krahas këtyre faktorëve me ndikim të drejtpërdrejtë duhen konsideruar edhe faktorët me ndikim të tërthortë. Përfshirja e të trajnuarve në praktikën e kompanisë zvogëlon përpjekjet për të gjetur punonjës dhe për të trajnuar fuqi punëtore (nga jashtë), si edhe të jep mundësinë të kesh një farë fleksibiliteti në caktimin e detyrave të punonjësve. Gjithashtu në të shumtën e rasteve kjo rrit besnikërinë dhe kohëqëndrimin në ndërmarrjen „e dikurshme“. Duke marrë në konsideratë këto efekte, ekonomia gjermane, me rreth 1.4 milionë praktikantët ne kompani, investon çdo vit në arsim rreth 7,7 miliardë euro dhe kjo shumë tregon një investim të mirë afatmesëm deri afatgjatë.

Këtë trend të vazhdueshëm për arsimin akademik në Gjermani e hasim edhe në shumë vende të tjera, të cilat interesohen për modelin e arsimit dual. Një nga sfidat më të rëndësishme për të gjithë aktorët e përfshirë qëndron në forcimin e imazhit të trajnimit praktik në ndërmarrje, të profesioneve jo-akademike dhe të veprimtarisë profesionale. Mungesa e njohurive mbi shumëllojshmërinë e profesioneve, mundësitë e zhvillimit dhe të karrierës si edhe reputacioni, në dukje më i lartë, i profesioneve akademike kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në këtë drejtim.

Megjithatë, zgjidhja nuk gjendet as duke u ankuar për një „mbi-akademizim“ dhe as duke vënë kundra njëri-tjetrit arsimin profesional dhe atë akademik. Përkundrazi, është e nevojshme, madje që në shkollën e përgjithshme, të krijohen qendra këshilluese për të orientuar mbi profesionin dhe degën e studimit të cilat do të informojnë mbi barazvlefshmërinë e rrugëve të ndryshme të karrierës dhe do të hapin mundësi zhvillimi nga më të ndryshmet. Duhet pranuar se nuk mund të ketë një recete për çdo shoqëri mbi marrëdhënien e „duhur“ dhe të balancuar të kualifikimeve profesionale nga më të ndryshmet. Zgjedhja e lirë e profesionit, vlerësimi real i interesave dhe aftësive vetjake, kërkesat e tregut si edhe strukturat aktuale janë rezultati i një diskutimi shoqëror, i cili shpesh mund të jetë i gjatë dhe i lodhshëm.

Si të përshtasim Nevojat e Biznesit dhe Aftësitë e Orientuara drejt Punësimit të të Rinjve



Një përmbledhje e pyetjeve dhe përgjigjeve

Moderator: Ardian Haçkaj, ShtetiWeb

Raportues: Leonard Dalipi, GIZ

Paneli: Z. Arben Ahmetaj, Ministër për Zhvillimin Ekonomik, Turizmin, Tregtinë dhe Sipërmarrjen

Z. Blendi Klosi, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë

Z. Jürgen Hollstein, Drejtor Ekzekutiv (CEO), Organizata Gjermane e Punëdhënësve për Formim Profesional dhe Formim të Mëtejshëm

Drejtuar dy ministrave: Si është bashkëpunimi mes bizneseve dhe shkollave dhe kur jeni takuar për herë të fundit për të diskutuar mbi këtë çështje?

Arben Ahmetaj: Ne jemi takuar shumë shpesh kohët e fundit. Biznesi kërkon nga qeveria të luftojë korrupsionin dhe njëkohesisht të trajtojë profesionistët për kualifikimet e kërkuara. Një institucion duhet të marrë përgjegjësi për menaxhimin dhe koordinimin tërësor të sistemit të arsimit profesional. Është e qartë se kjo përgjegjësi i takon Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Blendi Klosi: Ne jemi takuar shumë shpesh, përkatësisht gjatë grupeve të punës. Ne kemi bërë një vizitë në gjithë vendin afër bizneseve dhe shkollave profesionale për të kuptuar potencialin e bashkëpunimit mes studentëve, bizneseve dhe qeverisë.

Drejtuar Z. Hollstein: Në Gjermani, kostot për studentët e arsimit profesional janë të larta, por ajo që merret në këmbim është akoma më e rëndësishme. Në Shqipëri vetëm 5% e bizneseve përfshihen në sistemin e arsimit profesional. Përse është kjo përqindje kaq e ulët në Shqipëri dhe si arrinë bizneset gjermane të përfitojnë nga investimi i tyre?

Jürgen Hollstein: Kompanitë gjermane kanë përgjegjëshmëri të lartë sociale. Për këtë arsye shumë prej tyre përfshihen në sistem. Ne kemi gjithashtu një traditë të madhe në këtë drejtim. Si rezultat, arsimi profesional në Gjermani ka një imazh shumë të mirë.

Bizneset gjermane e mbështesin arsimin profesional për interes të tyre, pasi studentët e trajnuar do të bëhen në të ardhmen punonjës të kualifikuar të cilët njohin nevojat e sektorit të biznesit. Në këtë mënyrë kompanitë përfitojnë financiarisht dhe do të kenë punonjës të trajnuar që do të përfshihen me njohuri të plota në ciklin e prodhimit ose në administratë duke siguruar të ardhura më të mira.

Drejtuar Z. Klosi: Cili është vizioni juaj për të inkurajuar arsimin profesional në Shqipëri? Kush janë partnerët?

Blendi Klosi: Ne kemi filluar të sjellim në vëmendjen e publikut arsimin profesional. Por nuk jam i bindur se sa të sukseshëm do të jemi pasi ende na mungojnë laboratorët, njohuritë, mësuesit e trajnuar etj. Ne shpresojmë që nëpërmjet arsimit profesional, do të krijojmë një brez të ri profesionistësh që do të punojnë dhe do të kujdesen edhe financiarisht për familjet e tyre që prej moshës 18 vjeçare. Ne kemi ndërmarrë tashmë disa hapa për këtë reformë: kemi rritur investimet për arsimin profesional, kemi sjellë biznesin më afër shkollave dhe përfshirjen e tyre në borde, etj.

Ne gjithashtu do përpiqemi të krijojmë shkolla cilësore që do të lidhen me shkolla si-motra në BE dhe të ofrojmë diploma të pranuar në Shqipëri dhe në tregun e Bashkimit Evropian. Në këtë këndvështrim, unë besoj se do t'ja arrimë këtij qëllimi pasi këto nuk janë objektiva të donatorëve, por shumë më tepër, ato janë objektivat tona!

Drejtuar Z. Ahmetaj: Si e shihni efektin e një force të pakualifikuar pune në interesin e investitorëve të huaj në Shqipëri?

Arben Ahmetaj: Zona e Lirë Ekonomike pritet të sjellë deri në 90.000 vënde të reja pune. Por kjo mund të dështojë për shak të mungesës së forcës së kualifikuar të punës. Do të nevojitet kohë për ekonominë tonë të zhvillohet, dhe kjo nuk mund të bëhet as duke fjetur, as duke ndenjur në shtëpi.

Në buxhetin e ardhshëm, ne shpresojmë të rrisim fondin deri në 1.5 herë për arsimin profesional. Ligji i Zonës së Lirë Ekonomike do të vendosë se kostot e biznesit për trajnimin dhe R&D do të llogaritet dyfish në krahasim me pagesën e biznesit për taksat.

Drejtuar Z. Hollstein: Çfarë duhet të bëjmë për të aplikuar Sistemin Dual në Shqipëri?

Jürgen Hollstein: Sistemi Dual Gjerman nuk mund të eksportohet, por Shqipëria mund të huazojë disa nga parimet e tij dhe ti adaptojë me nevojat në vend. Ka shumë shtete që kanë eksperimentuar dhe më pas janë përpjekur ta adaptojnë në sistemet e tyre. Në mënyrë që kjo të funksionojë në Shqipëri, ju mund të filloni me një projekt pilot, me diçka të vogël, e më pas të mësoni, ta zhvilloni dhe ta shpërndani atë. Përpiquni të identifikoni biznese që janë të gatshme të bashkëpunojnë. Duke pasur rezultate pozitive, do të keni shëmbuj të mirë të tregoni, para se ta zbatoni atë. Ju duhet të krijoni një imazh të mirë për arsimin profesional.

Drejtuar Z. Klosi: Cilat janë planet e Ministrisë për industrinë e agrikulturës?

Blendi Klosi: Ne kemi disa shkolla për industrinë e agrobiznesit. Për shembull, në shkollën profesionale të agrikulturës në Fier, kemi bërë një investim të targetuar dhe rezultatet kanë qenë mjaft të mira. Numri i studentëve është rritur nga disa, në 200. Ne na nevojiten më tepër shkolla të tilla.

Drejtuar dy Ministrave: A mund të luajnë një rol kompanitë publike dhe të huaja në mbështetjen e zhvillimit të arsimit profesional në Shqipëri?

Arben Ahmetaj: Qeverisë i duhet të ketë rolin e saj në zhvillimin e sistemit të arsimit profesional ndërkohë kompanitë si psh., OSHEE, mund të shërbejnë si partnerë në instrumentalizim e sistemit dhe krijimin e platformave nxitëse.

Blendi Klosi: Ne kemi tashmë një bashkëpunim të mirë me këto kompani, për shkak se atyre ju nevojitet forcë e kualifikuar pune.

Drejtuar Z. Ahmetaj: Kur do të punojnë kompanitë Shqiptare me standardet e BE-se?

Arben Ahmetaj: Ne po punojmë në këtë drejtim. Arsimi profesional do të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e vazhdueshëm të konvergencës.

Gjetjet kryesore:
▪ Marrëveshje e përgjithshme: lidhja mes praktikës dhe teorisë është e nevojshme – në shkolla dhe kompani.
▪ Ka tashmë shëmbuj të mirë të bashkëpunimit mes biznesit dhe shkollave. Ministrat do të mbështesin këto procese të nevojshme.
▪ Të dy ministrat do të bashkëpunojnë për zhvillimin e trajnimit profesional dhe do ta thellojnë më tepër këtë bashkëpunim.
▪ Kompanitë duhet të ndihen të përgjegjshme për arsimimin profesional të gjeneratës së ardhshme të punëtorëve. Është në interesin e tyre të rrisin kualitetin e produkteve dhe shërbimeve sipas standardeve Evropiane.
▪ Imazhi i trajnimit profesional duhet të përmirësohet – nëpërmjet fushatave dhe shëmbujve pozitivë.
▪ Qeveria ndihet e përgjegjshme për zhvillimin e një sistemi të arsimit profesional në Shqipëri dhe do të përfshijë gjithashtu publikun dhe kompanitë e huaja.

Paneli I: “Ndërtimi & Infrastruktura”

Moderatore: Anette Kasten, DIHA

Panelistët:

- **Viola Eski**, Prodhime Karbonike Sh.A
- **Ivaylo Garbev**, Lindner Group
- **Devis Pllaha**, Korca Construction School
- **Alqi Mustafai**, AKAFPK

Raportuesit:

- **Megi Lubani / Brenton Kotorri**

Subjekti:

Fokusi i grupit të punës ishte sektori i ndërtimit në Shqipëri si pjesë e rëndësishme e një politike infrastrukturore të qëndrueshme. Ky sektor, veçanërisht në fazën e transformimit ishte motor i zhvillimit ekonomik të vendit, i cili në këtë periudhë ka dëshmuar përgjithësisht norma të larta të rritjes ekonomike. Megjithatë, në shumicën e rasteve i kushtojmë më shumë rëndësi sasisë sesa cilësisë. Në vitet e fundit industria e ndërtimit ka pësuar ulje të ndjeshme e cila vjen për shkak të mungesës së likuiditetit në treg, pjesërisht e shkaktuar nga gadishmëria e ulët për të paguar kontratat shtetërore. Qeveria shqiptare është në proces të shlyerjes së detyrimeve, çka ka sjellë që tregu sërish të ketë më tepër likuiditet. Për shkak të mbikapacitetit u vendos një bllokim ndërtimesh në mbarë vendin për ndërtime të reja, prandaj rritja e sektorit të ndërtimit mbetet ende e ulët. Kjo jep shkas për reflektim të thellë mbi përmirësimin e cilësisë dhe kompetencës në këtë sektor. Momentalisht, sektori përqëndrohet në plane të reja të miratuara dhe në renovimin e ndërtesave ekzistuese.

Firmat e ndërtimit në Shqipëri, të cilat synojnë të kenë standarte cilësore kërkojnë më kot fuqi punëtore të kualifikuar dhe shpeshherë janë të detyruara të punësojnë specialistë të kualifikuar të huaj. Punëtorët shqiptarë të kualifikuar janë kryesisht të vjetër në moshë, që do të thotë se ata janë aftësuar para 1990-ës. Më pas trajnimi i specialistëve në sektorin e ndërtimit mori tatëpjetën. Si rrjedhojë, impulset e modernizimit në ndërtim, deri tani, nuk vihen re në arsimin përkatës.

Diskutimet në panel: Problematika, Komente dhe Rezultate:

Gjatë prezantimeve, nga këndvështrime të ndryshme, kualifikimi profesional u identifikua nga panelistët si një element thelbësor për të patur në të ardhmen një zhvillim të qëndrueshëm në sektorin e ndërtimit. Për këtë do të ishte i domosdoshëm një komunikim më i mirë mes industrisë së ndërtimit dhe shkollave. Vetëm atëherë shkollat profesionale do të kuptonin se çfarë nevojitet sot për ushtrimin e kualifikuar të një profesioni. Veç kësaj duhet të funksionojë edhe shkëmbimi i informacionit mes shkollave profesionale përkatëse për të mësuar nga njëra-tjetra.

Meqë imazhi i profesioneve jo-akademike vazhdon të jetë ende shumë i keq duhet të punohet më shumë në këtë drejtim. Kjo e parë nga dy këndvështrime:

1. Duhet të zhvillohen fushata informuese të përshtatshme për të rinjtë dhe prindërit e tyre, në mënyrë që të fuqizohet atraktiviteti për kualifikimin profesional jo-akademik: „Proud to be a craftsman“.
2. Njëkohësisht duhet të krijohen instrumente nxitëse financiare për specialistët e kualifikuar, në veçanti, për të diplomuarit e shkëqyer të kualifikimit profesional.

Pala e punëdhënësve kërkon kushte ligjore më të mira nga politika, për të zgjeruar sektorin e praktikës. Edhe legjislati i sektorit të ndërtimit është i vjetëruar (1974) dhe nuk përputhet më me kushtet e sotme.



Prandaj kërkohet përshtatja e cilësisë në arsim dhe e produkteve me standartet ndërkombëtare.

Në shkolla mungon kualifikimi i mëtejshëm i mësuesve, infrastruktura përkatëse dhe bashkëpunimi i institucionalizuar me kompanitë. Për këtë do të ishte i domosdoshëm një sistem i qëndrueshëm për të integruar në mënyrë të detyrueshme praktikën dhe për të rakorduar me njëra-tjetrën kurrikulat. Deri tani ka qenë e mundur pothuajse vetëm nëpërmjet kontakteve personale të drejtpërdrejta të ofroreshin praktika për nxënësit.

Në përgjithësi kërkohet që të ketë një „listë të profesioneve më të kërkua“. Gjatë diskutimit nuk u bë e qartë se cili institucion duhet të ishte përgjegjës për këtë. Të gjithë janë të mendimit që me rritjen e kontraktuesve publikë dhe të sektorit privat të ndërtimit në „Partneritet publike-private“ ka edhe mundësi të tjera për të përmirësuar cilësinë dhe standartizimin.

Gjetjet kryesore:

- **Bashkëpunimi mes aktorëve të ndryshëm, kompanive, shkollave dhe politikës, duhet rakorduar dhe përcaktuar qartë detyrat e gjithësecilit për të zhvilluar një sistem bazë unik për zhvillimin e cilësisë.**
- **Shkëmbimi mes shkollës dhe kompanisë duhet të institucionalizohet në mënyrë që shkollat të arrijnë nivelin teknologjik të kohës dhe nxënësve t’u ofrohen praktika sipas standarteve. Gjithashtu shkollat duhet të bashkëpunojnë më mirë me njëra-tjetrën për të shkëmbyer modele suksesi.**
- **Atraktiviteti i profesioneve të ndërtimit duhet të rritet si nëpërmjet fushatave informuese dhe reklamuese ashtu edhe nëpërmjet një page më të mirë për një punë më cilësore.**
- **Partneritetet publike-private duhet të shërbejnë edhe për të përmirësuar kualifikimin profesional në kuadër të zbatimit, nëpërmjet praktikave dhe kurseve në ndërmarrje, si edhe rritjes së standarteve të cilësisë.**

Paneli II: “Industria Tekstile & e Lehtë”

Moderatore: Sonila Limaj, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)

Panelistët:

- **Bernd Naber**, Kompania Naber
- **Daniel Guçe**, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
- **Adriana Cibaj**, Shkolla e Mesme Ekonomike
- **Brikena Nallbani**, Shërbimi Kombëtar I Punësimit (SHKP)

Raportuesit:

- **Sokol Kondi / Fiorin Dervishi**



Subjekti:

Në sektorin e industrisë së lehtë me rreth 31.000 punonjës, afërsisht 90% e tyre janë të punësuar në fushën e tekstileve. Sektori i tekstileve kontribuon me rreth 3% në PPB. Është shumë herë më e lartë, me afro 34%, përqindja që ai zë në totalin e eksporteve shqiptare. Shumica e kompanive të tekstitil janë sipërmarrje të përbashkëta mes kompanive të huaja (nga Italia, Turqia dhe Evropa Qendrore) dhe atyre vendase.

Industria shqiptare e tekstitil kryesisht shërben si furnizues dhe gjendet pothuajse në fillim të vlerës së shtuar ekonomike. Shkak për këtë janë teknologjia e vjetëruar dhe mungesa e punëtorëve të kualifikuar dhe shumë të kualifikuar, si në fushën e prodhimit ashtu edhe në këndvështrimin teknik. Atraktiviteti në sektorin e tekstitil nuk është shumë i madh për të rinjtë, pasi nga njëra anë kushtet e punës nuk përputhen me standartet bashkëkohore dhe nga ana tjetër ka vetëm paga të ulta (shpesh paga minimale arrijnë në 160 €, - në muaj).

Diskutimet në panel: Problematika, Komente dhe Rezultate:

Nga perspektiva e investitorëve ende nuk ka një bashkëpunim të mirë mes shkollave dhe industrisë së tekstitil. Industria e tekstitil është e gatshme të ofrojë praktika në të cilat mund të vihen në zbatim njohuritë teorike të përfituara. Për të arritur këtë, kompanitë – kjo është edhe në interesin e tyre - duhet të investojnë më shumë në burimet njerëzore nëpërmjet trajnimeve të brendshme. Për shembull, në lidhje me këtë disa kompani marrin edhe ekspertë të huaj. Megjithatë, kurrikulat e shkollave duhen ndryshuar në mënyrë të tillë që të ecin me të njëjtin hap me zhvillimin teknologjik të sektorit. Për më tepër, edhe mësimi i gjuhës angleze është i domosdoshëm, veçanërisht, në zonat rurale.

U theksua se pagat e ulta janë tërheqëse për investitorët, por ato nuk janë vendimtare për të ndërmarrë një investim. Prej dy vitesh shteti investon gjithmonë e më shumë në arsimin profesional, duke përmendur këtu edhe fushat më të specializuara, për të kontribuar afatmesëm në përmirësimin e produkteve.

Gjithashtu investitorët në sektorin e tekstitil duhet të hedhin më shumë vështrimin në zona të tjera të vendit pasi aty papunësia është shumë herë më e madhe, pra, nevoja për vende pune në sektorin me kualifikim të ulët është më e madhe se sa në Tiranë dhe në Durrës. Për shkak se në 25 vitet e fundit investimi në fushën e arsimit profesional është lënë shumë pas dore, sot gjendemi përpara problemeve pothuajse të pazgjidhshme për të përmbushur nevojat e industrisë për kualifikim, veçanërisht, në zona me përqëndrim të madh industrial.

Nga këndvështrimi i Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) nuk ka ende një bashkëpunim të mirë midis industrisë dhe industrisë së tekstitil. Kështu që, deri tani, vetëm 30 kompani të huaja i janë drejtuar drejtpërdrejt

SHKP-së, ndërkohë që shumica e kompanive i publikojnë vetë vendet e lira të punës. Edhe pse 50% e të papunëve të regjistruar vazhdojnë të jenë prej kohësh të papunë, shumë prej aplikantëve refuzojnë kushtet e punës dhe pagat e ofruara, të cilat nuk janë tërheqëse për ta. Sidoqoftë, duhet të ketë një ndërthurje dhe bashkëpunim shumë më të ngushtë midis SHKP-së dhe industrisë për të arritur rezultate sa më të mira.

Vazhdimisht ka patur ankesa mbi mungësen e mbështetjes nga ana e shtetit. Kjo vlen si për stimujt lidhur me taksat ashtu edhe për përmirësimet e tjera të kushteve për të thithur investime dhe investitorë të rinj dhe inovatorë.

Më tej, u bë thirrje, që veçanërisht në zonat strukturalisht të dobëta të krijohet një ofertë më e mirë për zhvillimin e arsimit profesional (bujqësia, fusha të tjera të industrisë së lehtë etj.)

Gjetjet kryesore

- **Tregu i punës nuk përmbush kërkesat e industrisë për punëtorë të kualifikuar – duhet të ketë më shumë informacione dhe trainime relevante.**
- **Punëtorët me kosto të ulët janë faktor nxitës, por jo vendimtar për rritjen ekonomike, gjithashtu, nevojiten punëtorë me kualifikim të lartë për prodhim, zhvillim teknologjik dhe administrim.**
- **Ende ka një mungesë bashkëpunimi midis SHKP-së dhe industrisë, nevojitet më shumë kontakt i drejtëpërdrejtë dhe zhvillim i përbashkët i trajnimeve etj. SHKP-ja mund të zhvillojë kurse dhe trajnime të veçanta për të përmbushur nevojat e industrisë.**
- **Bashkëpunimi i drejtëpërdrejtë midis industrisë dhe shkollave është i nevojshëm për të mësuar nga njëri-tjetri mbi atë që nevojitet dhe ofrohet, shkollat duhet të vizitojnë kompanitë dhe kompanitë duhet të ofrojnë informacione në shkolla.**
- **Kushtet e punës në industrinë e tekstitit duhet të përmirësohen, gjithashtu edhe pagat duhet të rriten sipas kërkesave.**
- **Investitorët duhet të fokusohen edhe në rajone të tjera të Shqipërisë, por, këto rajone duhet të jenë të përgatitura më mirë për investime.**

Paneli III: “Kujdesi Shëndetësor & Kujdesi për të Moshuarit”



Moderator: Skënder Dule, SANUS

Panelistët:

- **Daklea Shtylla**, Shtëpia e Zotërinjve
- **Marsela Robo**, AKAFPK
- **Elidona Ukshini**, Qendra Multifunkionale Kamëz
- **Rezarta Shehu**, Shërbimi Social Shtetëror
- **Prof. Kosta Barjaba**, Ministria e Shëndetësisë

Raportuesit:

- **Albana Zeqaj / Gentiola Madhi**,

Subjekti:

Sektori i shëndetësisë i deritanishëm nuk është ngritur duke u bazuar në parandalimin dhe shërbimin e kujdesit. Përkujdesja tradicionale në familie, prej shumë kohësh, nuk është e mjaftueshme. Zhvillimi i pritshëm demografik tregon që pikërisht në sektorin e përkujdesjes do të ketë nevoja të konsiderueshme për fuqi punëtore të kualifikuar, mbi të gjitha, edhe për specialistë të arsimuar nën nivelin akademik. Krahas institucioneve shtetërore të përkujdesjes për moshën e tretë konstatohet dhe një rritje e vazhdueshme e organizmave private. Gjithashtu edhe kërkesat ndaj shërbimeve të përkujdesjes po ndryshojnë. Veçanërisht i ri është kujdesi profesional në shtëpi. Kjo do të ishte një nga fushat, e cila do t'u ofrohej të diplomuarve në shkollat profesionale.

Përtej kësaj duhet menduar mbi ndërtimin e një sistemi modern të fokusuar më shumë te parandalimi dhe kujdesi, i cili do të ishte më pak i kushtueshem sesa një sistem i thjeshtë sigurimi. Në arsimimin e personelit spitalor dhe të punonjësve të shërbimit të kujdesit ndaj moshës së tretë e tërë qasja merr një kuptim gjithmonë e më të rëndësishëm, ndërsa arsimit vazhdon të jetë i orientuar në njohuritë faktike. Punonjësit në fushën e kujdesit nuk janë me kualifikimin e nevojshëm dhe urgjentisht duhen trajnuar.

Ka një boshllëk të madh midis zhvillimit teknologjik dhe arsimit statik në sektorin shëndetësor. Ka mungesë të teknikëve, të cilët mund të mirëmbajnë aparaturat moderne të spitalit.

Deri tani bashkëpunimi midis universiteteve (arsimimi i infermiereve/infermierëve) dhe shkollave të cilat ofrojnë praktika nuk është zgjeruar në mënyrë sistematike. Ka disa shembuj të mirë, por ende mungon një ndërthurje e bazuar në kurrikula. Institucionet, të cilat ofrojnë praktika kanë nevojë për një personel të kualifikuar për të mbikëqyrur praktikantët. Gjithashtu mungojnë mësues të kualifikuar për degët e ndryshme të sektorit të përkujdesjes. Kjo prek gjithashtu edhe mësuesit e specializuar për mirëmbajtjen e pajisjeve spitalore.

Diskutimet në panel: Problematika, Komente dhe Rezultate:

U kërkua një ndryshim i domosdoshëm dhe një zhvendosje e arsimit në universitete dhe në shkolla. Në veçanti i duhet dhënë më shumë rëndësi arsimit dual (teori dhe praktikë), dhe praktika, si pjesë përbërëse e arsimit, duhet të rritet në mënyrë të ndjeshme. Për profesionet e përkujdesjes nevojiten gjithnjë e më shumë kualifikime edhe në fushën jo-akademike, pjesa praktike edhe këtu duhet të ketë një vend të madh. Praktikrat duhet të integrohen në mënyrë sistematike në të gjithë planin arsimor. Kurrikulat përkatëse për pjesën përbërëse praktike të arsimit duhet të përmbajnë edhe komponentë sociale. Në institucionet bashkëpunuese të përkujdesjes duhet të ketë përgjegjës të kualifikuar (mentorë) në dispozicion të praktikantëve edhe për faktin se ata kanë një vështrim aktiv në të gjithë planifikimin e arsimit. Përveç kësaj për praktikrat e kryera duhet të jepet çertifikata sipas performancës. Arsimit dhe kurrikulat e tij duhet të njehsohen në mbarë vendin dhe të

jenë të koordinuara mes niveleve të ndryshme.

Për të rritur vlerësimin e qytetarëve ndaj personelit të përkujdesjes duhet që kjo të promovohet në publik. Përfshirja e profesionit të kujdestarit për të moshuarit (jo-akademik), si profesion i njohur, (regulated profession) në dhomën e infermierëve (Chamber of Nurses) përbën një hap të rëndësishëm në këtë drejtim.

Të rinjtë, që janë të interesuar për një kualifikim në këtë fushë, duhet të njihen më herët dhe në mënyrë më intensive me kërkesat e profesioneve të kujdestarit. Jo çdokush është i përshtatshëm. Prandaj, edhe një përzgjedhje paraprake e kandidatëve për kualifikim kontribuon në përmirësimin rrënjësor të kualifikimit dhe, anasjelltas, duhet të ketë një këshillim karriere më intensive.

Atraktiviteti i profesioneve duhet të përmirësohet edhe nëpërmjet pagave sipas performancës. Ndryshime në paga për të diplomuarit akademikë dhe jo-akademikë të përshtaten sipas performancës.

Gjetjet kryesore

- E domosdoshme është njohja shtetërore e profesioneve të ndryshme në fushën e përkujdesjes.
- Nevoja në sektorin e përkujdesjes është rritur jashtëzakonisht shumë. Gjithashtu kjo prek veçanërisht edhe profesionistë nga fusha jo-akademike. Nevoja e tregut të punës duhet të përcaktohet dhe të koordinohet nga ministritë dhe institucionet përkatëse.
- Veçanërisht në sektorin e përkujdesjes konstatohet që një kualifikim i mirë sjell edhe shërbime më të mira. Ofruesve të përkujdesjes u duhet bërë me dije se çfarë kualifikimesh mund të sigurojë sot arsimit profesional modern.
- Kujdestarëve të kualifikuar u duhet dhënë prioritet në caktimin e vendeve të punës.
- Për të rritur atraktivitetin e kandidatëve të mundshëm duhet të ofrohen paga sipas performancës, pavarësisht nga arsimit akademik apo jo-akademik.
- Në përgjithësi është e domosdoshme të përmirësohet imazhi dhe të rritet vlerësimi i arsimit profesional në sektorin e përkujdesjes. Për të arritur këtë kërkohen medoemos përpjekje të përbashkëta të ministrive përkatëse dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
- Kërkesa dhe diversiteti i arsimit profesional përkatës janë në rritje. Sidoqoftë, pjesa praktike duhet të jetë pjesë e detyrueshme e kualifikimit profesional, më së miri praktika intensive nga 2 deri në 4 javë, të cilat të jenë të integruara sa më mirë në kurrikula. Kurrikulat përkatëse duhet të përmbajnë edhe formimin e kompetencave sociale.
- Për të zhvilluar kurrikula sipas nevojës dhe për t'i zbatuar ato edhe në arsim duhet të institucionalizohet bashkëpunimi i ngushtë mes kompanive të përkujdesjes, shkollave dhe kompanive. Logjikisht ketu bën pjesë edhe bashkëpunimi i ngushtë gjatë provimeve dhe çertifikimeve.
- Për këtë qëllim kompanitë duhet të kontribuojnë në shkolla – të jenë pjesë e bordeve të shkollave dhe anëtarët e bordeve të shkollave duhet të ofrojnë edhe mundësi për të kryer praktikë.
- Është e domosdoshme të përcaktohet përshtatshmëria e kandidateve dhe kandidatëve për një profesion kujdestarie. Këtu bëjnë pjesë edhe aktivitete informuese për të rinjtë (dhe prindërit e tyre) në shkolla dhe zyrat e punës.
- Personeli kujdestar i punësuar duhet të marrë rregullisht oferta për kualifikime të mëtejshme.

Paneli IV “Turizmi”

Moderatore: Etleva Vertopi, GIZ

Paneli:

- **Matilda Naço**, Shoqata Shqiptare e Turizmit
- **Silva Banushi**, Drejtor i përgjithshëm i Punësimit, Politikave të Arsimit dhe Formimit Profesional, MMSR
- **Pirro Jani**, Qendra e Formimit Profesional, nr. 4, Tirana
- **Alma Bitë**, Shkolla e Turizmit, Sarandë

Raportues:

- **Dafina Peci / Enian Lamce**



Subjekti:

Turizmi është industria më e madhe në botë dhe studimet parashikojnë një zhvillim në rritje të tij. Qeveria Shqiptare e konsideron turizmin si një prioritet kyç të programit të saj qeverisës dhe si një mjet për të arritur qëllimin madhor siç është ai i krijimit të vendeve të punës dhe ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme. Sot, sektori i turizmit në Shqipëri gjeneron rreth 4.8% të PBB (GDP). Më shumë se 50,000 persona janë të punësuar në këtë sektor, një shifër e cila trefishohet gjatë sezonit të verës.

Gjatë viteve të fundit ka pasur një progres pozitiv, por gjithsesi nuk ka qenë i mjaftueshëm për të shfrytëzuar në mënyrë efikase dhe për të zhvilluar potencialin e plotë që sektori ofron, në rritjen e të ardhurave dhe krijimin e mundësive të reja për punësim. Fakti se Shqipëria mbetet pas fqinjëve kur nevojitet shfrytëzim efektiv i burimeve dhe potencialeve të turizmit, nuk tregon se Shqipërisë i mungojnë resurset natyrore. Kjo situatë vjen kryesisht si pasojë e mungesës së forcës së kualifikuar dhe të aftë të fuqisë punëtore, mungesës së trajnimit cilësor profesional, si dhe rolin e kufizuar të shtetit si rregullator dhe mbikëqyrës.

Ideja e Sistemit Dual në degën e turizmit nuk është diçka e re për Shqipërinë. Në vitet e mëparshme ka pasur disa përpjekje për të implementuar këtë sistem (rasti i Durrësit), por procesi ka mbetur i pakompletuar për shkak të mangësive të kuadrit ligjor.

Një tjetër barrierë që ka penguar këtë proces është profili familjar i biznesit të kompanive që operojnë në industrinë e turizmit. Për shkak të lidhjeve familjare, këto kompani nuk e shohin si prioritet bashkëpunimin me shkollat profesionale, përkundrazi ata kërkojnë punonjës brënda rrethit të tyre familjar. Sot, në Republikën e Shqipërisë ka rreth 10.000 njësi hotelerie, shumica e të cilave janë biznese familjare.

Diskutimet në panel: Problematika, Komente dhe Rezultate:

U theksua nevoja se sektori shtetëror dhe ai privat duhet të veprojnë në partneritet për të krijuar një lidhje organike mes arsimit profesional dhe operatorëve të turizmit. Për shkak se industria e turizmit është kryesisht në pronësi të familjeve dhe sezonale, mekanizma të duhur me kritere përfaqësuese duhet të eksplorohen për të siguruar përfshirjen e biznesit në identifikimin e nevojës për personel të kualifikuar, zhvillim të kurrikulës, praktika dhe pjesëmarrje në testet shkollore.

Kuadri ligjor që rregullon sektorin e turizmit në Shqipëri është i pazhvilluar. Nuk ka një formë rregullatore në licensimin dhe akreditimin e njësive të shërbimit, e cila e bën imediate kërkesën për forcë pune të kualifikuar dhe çertifikuar sipas standarteve kombëtare.

Në nivel të sistemit AFP, ka dy elementë të dobët në zhvillimin e trajnimit dhe edukimit efektiv për një sektor atraktiv të turizmit. 1. Infrastruktura me pajisje të papërshtatshme, mungesa e laboratorëve dhe mungesa e materialeve të tjera mbështetëse; 2. dhe kurrikula e cila ka qenë shpesh subjekt i ndryshimit. Këto ndryshime

nuk kanë sjellë gjithmonë rezultatet e pritshme. Rishikimi i fundit i kurrikulës ka sjellë një zhvendosje të fokusit nga praktika drejt teorisë duke e bërë atë jo-relevante. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, jemi larguar nga objektivi madhor i arsimit profesional, trainimit në praktikë dhe kualifikimit të studentëve.

Një problem tjetër lidhur me arsimin është çertifikimi i studentëve pas përfundimit të kurseve profesionale. Proçesi i çertifikimit është kthyer në një formalitet dhe nuk tregon përgatitjen reale të studentëve. Çertifikatat as nuk i motivojnë as nuk i penalizojnë studentët për shkak se ato nuk kategorizojnë studimet duke e lënë të paqartë vlerësimin e tyre në terma të shprehive praktike dhe shërbimit.

Për sa i përket praktikave profesionale, legjislacioni Shqiptar është ndëshkues kundrejt entiteteve serioze dhe kualitative që operojnë në industrinë e turizmit. Këto subjekte janë të ngarkuar me barrë fiskale për çdo praktikant që marrin. Kjo sjell një fluks të praktikantëve pranë entiteteve të turizmit, të cilët bëhen shpesh pjesë e ekonomisë informale, ose operojnë me standarte të ulëta.

Gjithashtu, perceptimi publik dhe imazhi i shkollave profesionale përbën problem, pasi ato konsiderohen ende si vënde për studentë me nivel të ulët. Për shkak të cilësisë së ulët dhe standarteve të varfëra në mësimdhënie këto shkolla konsiderohen nga prindërit dhe studentët në rastin më të mirë si trampolinë për të rritur mesataren për të lehtësuar pranimin në Universitete. E gjithë kjo ka çuar në krijimin e një imazhi negativ për këto shkolla. Duhet theksuar se fushatat informuese nuk duhet të fokusohen vetëm drejt studentëve por gjithashtu te prinderit e tyre të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në këtë zgjedhje.

Gjetjet Kryesore

- **Ka një nevojë për profesionistë në gjithë hallkat e zinxhirit të sektorit të turizmit (shërbimë, hoteleri, turizëm, etj.)**
- **Kuadri ligjor për turizmin duhet të zhvillohet. Ekziston nevoja për akreditim dhe udhëzim për të garantuar standardet minimale të ofertave dhe shërbimeve. Pra biznesi në turizëm duhet të trajnohet, dhe kurrikula të jetë e përshtatur me standartet e vendosura.**
- **Kuadri ligjor duhet të sigurojë dhe mundësojë që trajnimi profesional të ofrohet në kompanitë e biznesit. Dispozitat përkatëse ligjore duhet të rishikohen për të adresuar nevojën për punën praktike të rinjve në kompani, duke respektuar ligjet ekzistuese mbi moshën minimale të punës, inspektimit dhe sigurisë në punë.**
- **Për të zhvilluar një shërbim më të mirë duhet të vendoset objektiv në certifikimin dhe kategorizimin e hoteleve dhe restoranteve. Me vlerë do të ishte gjithashtu sistemi i konkurrencës i mbështetur në meritë dhe profesionalizëm.**
- **Kurrikualat aktuale duhet të rishikohen dhe për këtë është e nevojshme përfshirja aktive e biznesit në praktikën e çertifikimit profesional. Nevojitet krijimi i certifikatave në mbarë vendin për të siguruar punëdhënësit mbi kualifikimin e aplikantëve.**
- **Funksionet e mësuesve në shkolla duhet të vlerësohet. Përtej testimit duhet të ofrohen trajnime si dhe çertifikime për mësuesit dhe instruktorët.**
- **Rritje e pjesëmarrjes aktive dhe rolit të biznesit në bordet e shkollave, duke vendosur kriteret transparente dhe anëtarësi në bazë të meritave.**
- **Duhet të ofrohen më shumë incentiva për bizneset në zhvillimin e trajnimit dhe praktikave profesionale në vendin e punës.**

Një politikë arsimore gjithëpërfshirëse dhe e orientuar drejt profesionit është çelësi për zhvillimin e ekonomisë shqiptare



Frank Hantke

Më shumë se 60% e të rinjve shqiptarë do të donin të iknin nga vendi i tyre një orë e më parë. Kjo, jo sepse ata nuk e duan më vendin e tyre, por sepse aty nuk shohin më perspektiva profesionale. Zhvillimi ekonomik i vendit mund të cilësohet më shumë si i mbetur në vend, sesa i begatë, megjithëse shumë ekspertë të huaj dhe vendas, donatorë e të tjerë, përpiqen që prej mbi 20 vite për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Por të dyja këto pohime janë anët e së njëjtës medaljeje!

Stanjacioni ekonomik dhe papunësia rinore janë një problem i përbashkët

Sigurisht që ka një sërë arsyesh se pse buma ekonomik nuk ka ecur përpara siç mendohej të ishte, duke pasur parasysh potencialet e mira që ka vendi. Kjo, pasi Shqipëria ka burime të pasura natyrore, si edhe një nga popullsitë më të reja në gjithë Europën. Megjithatë, pa folur për vullnetin politik të elitave të vendit, që ende mungon, ato duhet të gjejnë gjuhën e përbashkët dhe të veprojnë bashkërisht mbi çështjet më të rëndësishme të së ardhmes dhe jo të bllokojnë në mënyrë të ndërsjellë njëri-tjetrin. Gjithashtu, nuk duhet ankuar që situata fillestare e Shqipërisë pas 1990-s ishte shumë e keqe në krahasim me shumë vende fqinje të saj. Pra, nuk bëhet fjalë për të gjetur fajtorin ose për justifikime banale, por për gjetjen e rrugëve që të shfrytëzohen në mënyrë më efektive potencialet e përmendura.

Për ndërtimin e një shtëpie nevojitet vetëm një arkitekt, por 20 zanatçinj

Ka pasur periudha në Shqipëri, kur rritja ekonomike ka arritur madje nivelin 6% ose 7%. Por, këto ishin zhvillime afatshkurtra në disa sektorë si industria e ndërtimit dhe jo dëshmi e një modernizimi të strukturuar të ekonomisë në tërësi. Në vitet e fundit, norma e rritjes lëvizte më shumë midis 0% dhe 3%, çka do të thotë, që vendi është ende larg nga zhvillimi real i rritjes së BE-së. Për të arritur të paktën të dhënat më të ulëta të ekonomisë së BE-së nevojiten norma të qëndrueshme të rritjes prej 6% ose më shumë. Por, strukturalist, deri tani në ekonomi ka ndryshuar shumë pak. Kjo vlen veçanërisht për sektorin e prodhimit, ndërkohë që vetëm sektori i konsumit është zgjeruar. Por, një ekonomi e cila në thelb bazohet vetëm te shërbimi dhe konsumi nuk mund të konsiderohet si e shëndetshme dhe e qëndrueshme. Potencialet për prodhim janë ende të pashfrytëzuara. Kjo vlen për bujqësinë, për energjinë, për industrinë, për zejtarinë, si dhe për sektorin e turizmit. Përse ka kaq pak investime, pse shkojnë dëm kaq shumë programe ndihme dhe mekanizma financimi?

Arsimi universitar shpesh nuk të çon gjëkund

Pavarësisht deficiteve serioze politike dhe administrative të lartpërmendura, bie në sy fakti që një brez i tërë i të rinjve është i paarsimuar, në mënyrë të gabuar ose, të paktën, jo me një qëllim të qartë dhe kështu do të vazhdojë të jetë. Edhe ligji për arsimin e lartë nuk do të sjellë asnjë ndryshim! Orientimi tërësisht i njëanshëm i politikës së arsimit drejt zgjerimit sasior të ofertës së arsimit të lartë ka çuar më tepër në përkeqësim të situatës. Kjo ka ndodhur për dy arsye: së pari, sot kudo mungojnë jo-akademikë të mirësimuar si p.sh. zanatçinj, punëtorë në sektorin e industrisë, sekretare ose personel mirëmbajtjeje dhe, nga ana tjetër, të rinjtë e shohin veten pothuajse të detyruar për të pasur një diplomë të çfarëdoshme, pa marrë parasysh nëse ajo do t'u nevojitet ose nëse do t'u përshtatet interesave përkatëse. Brezi i prindërve të sotëm, përfshirë këtu dhe politikanët e tyre, kanë krijuar një iluzion mbi arsimin dhe të ardhmen, i cili nxit pasiguri te fëmijët e tyre ose largimin e tyre nga vendi.

Zanati si një alternativë arsimit deri tani pothuajse nuk ekziston

Pothuajse askush nuk dëshiron, që fëmija i tij të ketë “vetëm” një zanat të mirë – edhe pse kështu ai do të kishte premisat më të mira. Kush mendon se mund ta përballojë financiarisht e dërgon fëmijën e tij në universitet. Përndryshe, prindi e konsideron veten si dështak, pasi e ka lënë fëmijën e tij në varfëri. Çfarë budallallëku i madh. Po të shohësh numrin e lartë të të papunëve mes akademikëve të rinj! Edhe më keq: mijëra akademikë të papunë konkurrojnë me joakademikë në tregun e kufizuar të punës për vende pune – pavarësisht se për çfarë vendi, qoftë në call center, si sekretare ose hostes, si kamerier ose në degë të tjera profesioni tërësisht joakademike. Të vetmit humbës janë ata, të cilët nuk kanë një diplomë universitare, me gjithë vlerën e ulët që ajo ka. Shpesh këta janë të rinj nga zonat rurale ose në përgjithësi të rinj nga shtresat më të varfra.

Tregu shqiptar i punës nuk është aspak treg, ndërsa investitorët kërkojnë fuqi punëtore të kualifikuar, por tregu i punës në Shqipëri ofron vetëm akademikë dhe të pakualifikuar.

Nëse do të ndalemi te përkufizimi “tregu i punës”, ai përbëhet nga dy terma të rëndësishëm: “Punë ose fuqi punëtore” dhe “treg”. Tregu i punës duhet të përfytyrohet si një treg i rregulluar, në të cilin blerësve të interesuar u ofrohen mallra dhe shërbime. “Blerësit” e fuqisë punëtore, sipërmarrës ose investitorë, kërkojnë në tregun e punës fuqi punëtore të kualifikuar, ndërkohë që “shitësit”, punëkërkuarit dhe të papunët, ofrojnë kualifikime, por për të cilat blerësit në ditët e sotme, fatkeqësisht, nuk interesohen pothuajse aspak ose pak. Për pasojë “blerja” nuk ndodh. Konkretisht kjo do të thotë: kush nuk punëson njerëz të rinj, nuk krijon as vende pune të reja dhe nuk kontribuon as në rritjen ekonomike. Atëherë investitorët shkojnë drejt tregjeve të tjera të punës më premtuese si p.sh. në vendet fqinje. Nëse do të pyeten investitorët, ata kërkojnë veçanërisht specialistë në segmentin e mesëm, çka do të thotë, të arsimuar në fushën e industrisë, të administratës ose zanatçinj. Një anketim përfaqësues i fondacionit “Friedrich Ebert” dhe i Shërbimit Kombëtar të Punësimit tregon, që kompanitë do të preferonin të punësonin të rinj që kanë mbaruar shkollën profesionale. Kjo, pavarësisht arsimit profesional aktual, me përjashtim të pak anëve shumë të mira, ka ende deficite të mëdha. Por një gjë është e sigurt: sa më tepër praktikë të ketë gjatë kohës së arsimit, aq më të mëdha janë shanset për të gjetur një punë. Fatkeqësisht për këtë ende nuk flitet as nga politikanët që merren me arsimin, as nga prindërit dhe fëmijët e tyre!

Specialistët nevojiten për të gjitha nivelet e tregut të punës dhe jo vetëm për “nivelet e larta”

Duke parë ekonomitë e zhvilluara, p.sh. në Europën Qendrore, bie në sy ekuilibri mes specialistëve joakademikë dhe akademikë. Nevoja për fuqi punëtore të kualifikuar shtrihet në të gjitha fushat e ekonomisë dhe të administratës. Në këto vende prej shumë kohësh është kuptuar, që për nevoja të ndryshme janë të domosdoshme profile kualifikimi të ndryshme, jo më të mira ose më të këqija, por të ndryshme! Çdo inxhinier mund të sjellë shembuj të shumtë nga jeta e tij në punë, ku njohuritë profesionale të një punëtori të mirëkualifikuar i kanë zgjidhur atij shumë probleme. Kështu, në Gjermani, një elektroaut e mëson zanatin e tij, po për aq kohë sa u nevojitet shumicës së studentëve në Shqipëri për të studiuar, pra 3 vjet. Shumë prej tyre vazhdojnë të mësojnë për të marrë titullin mjeshtër, duke fituar kështu të drejtën për të mësuar të rinj të tjerë. Për më tepër, titulli “mjeshtër” gëzon të njëjtin status si titulli “bachelor” në të ashtuquajturin sistemi i Bolonjës!

Të kombinosh praktikën me teorinë – krijimtari, aftësia për të punuar në skuadër dhe kompetenca për të planifikuar.

Këtu bëhet fjalë jo vetëm për shkollën profesionale, por edhe për të gjitha institucionet e tjera të edukimit, nga kopshti deri në universitet. Në Shqipëri, përcjellja e dijes më së shumti orientohet ende, në modele të vjetruara dhe hierarkike. Ende shumë fakte mësohen përmendësh – shumë më tepër sesa në sistemet moderne të edukimit. Duke pasur parasysh faktin që, pothuajse çdo ditë, volumi i informacioneve dhe fakteve rritet, të mësuarit e fakteve ka mbetur mbrapa dhe është vjetruar. Gjatë të mësuarit i duhet kushtuar më tepër rëndësi vazhdimësisë së këtij procesi në mënyrë të pavarur. Kjo do të thotë që duhet të dish se ku mund të marrësh informacionet e nevojshme në të ardhmen dhe, për më tepër, po t’i ndërthurësh ato siç duhet dhe t’i përdorësh në mënyrë të pavarur për detyra të reja që shtrohen.

Pra, nuk bëhet fjalë më për njohuri faktesh, përkundrazi, më tepër për të ashtuquajturat kualifikime kyçe (si të vazhdoj të mësoj dhe të siguroj informacione) dhe për “njohuri të lidhura me procesin”. Por, proceset nuk mësohen vetëm nga librat, ato duhet t'i ndërtojmë dhe provojmë vetë gjatë të mësuarit. Vetëm në praktikë mund të mësohesh nga gabimet.

Sot dhe në të ardhmen, aftësitë strategjike janë po aq të rëndësishme sa dhe aftësitë e të punuarit në skuadër. Këto të dyja mundësojnë të punuarit modern dhe bashkëpunimin efikas. Aq sa teorike tingëllon kjo, po aq praktike janë avantazhet e këtyre aftësive nëse synohet organizimi sistematik i proceseve të punës. Me punonjës që punojnë vetëm dhe me njohuri statike vështirë që mund të kryhen proceset komplekse të punës. Një vështrim në praktikën e Shqipërisë fatkeqësisht e dëshmon shpesh këtë. Për zhvillimin ekonomik të një vendi janë të domosdoshëm të rinj me aftësi kreative dhe për të punuar në skuadër, me përgjegjshmëri vetjake dhe kompetenca strategjike planifikimi. Shumë më pak të kërkuar janë punëtorët, të cilët marrin urdhra dhe janë të orientuar drejt hierarkisë në punë.

Në thelb, një arsim i bazuar në përgatitjen për profesionin duhet të bazohet në dy shtylla: praktikë – teori.

Bashkëpunimi ndërmjet arsimit profesional dhe politikës së tregut të punës krijon një “treg pune” të duhur

Është e qartë që arsimi profesional të bashkëpunojë ngushtë me politikën e tregut të punës në mënyrë që të mos shfaqen zhvillime të gabuara. Kujt i vijin në punë mijëra avokatë, ndërkohë që nevojiten inxhinierë, specialistë planifikimi, zanatçinj ose sekretare? Politika e tregut të punës nuk përcaktohet vetëm nga zyrat e punës por kryesisht nga kompanitë dhe investitorët. Kjo do të thotë që punëdhënësit duhet të luajnë një rol thelbësor në formësimin e arsimit profesional, nëse ata duan që në të ardhmen të kenë një personel të kualifikuar. Pra, bëhet fjalë që fillimisht të njihen nevojat e tregut të punës dhe, më pas, të nxirren konkluzionet për kualifikimet e domosdoshme dhe kompetencat profesionale, të cilat duhet t'u përcillen institucioneve arsimore. Por kjo nuk mjafton, pasi edhe punëdhënësit duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e kurrikulave. Punëdhënësit janë ata, të cilët e dinë më mirë se kushdo tjetër se çfarë nevojitet. Kështu edhe punëdhënësit duhet të marrin një pjesë të përgjegjësisë në certifikimin, në mënyrë që diplomat të njihen në mbarë vendin dhe, më vonë, edhe ndërkombëtarisht. Në këtë mënyrë, punëdhënësit dhe politika do të përpiqeshin në të ardhmen që “blerësit” në “tregun e punës” të gjenin ofertat e duhura. Kjo krijon vende pune dhe suksese të reja ekonomike.

“Plani B” për të rinjtë dhe prindërit e tyre – alternativa e rrugës së pakrye “Planit A”

Që në shkrimet e lashta latine hasim me termin, që prindërit duan gjithmonë më të mirën për fëmijët e tyre. Prandaj, pas ndryshimeve politike “Plani A” ishte ai, që prindërit të dërgonin fëmijën në një universitet. Kjo lidhej shpesh me vështirësi të mëdha, pasi në arsimin e lartë, që gjithmonë e më shumë po privatizohej, studimet ishin shtrenjtuar, duke ecur drejt zhvillimit të një biznesi shumë fitimprurës! Por vetë fëmijëve iu kushtua shumë pak vëmendje. Pothuajse nuk u morën fare parasysh talentet dhe dëshirat e tyre, mjaftonte që ata kishin filluar studimet. Në këtë mënyrë, për shumë të rinj filloi kalvari i vuajtjeve drejt një rruge pa krye. Kjo pasi nuk u tregua interes ndaj kurrikulave dhe objektivave të studimeve, por vetëm ndaj certifikatave.

Në Gjermani ka më shumë se mbi 300 profesione joakademike, kjo jo për shkak se është veçanërisht luksoze, por sepse në një ekonomi të zhvilluar këto profesione nevojiten. Nëse ekonomia e Shqipërisë synon të zhvillohet drejt integritit në BE, atëherë nevojitet një gamë shumë më e gjerë kualifikimesh të mira, veçanërisht në segmentin e mesëm të botës së punës.

Ajo çfarë nevojitet duhet krijuar dhe ofruar.

“Plani B”, një arsim profesional, është për prindërit dhe fëmijët e tyre në Shqipëri pothuajse i panjohur dhe deri tani përpjekjet e politikës dhe të ekonomisë për ta ofruar “Planin B” në publik dhe për ta promovuar atë si një alternativë të vërtetë të së ardhmes, janë shumë të pakta. (Cinikët mund të pretendojnë që kjo vjen edhe si

pasojë e asaj, që me një sistem arsimit profesional të orientuar drejt praktikës nuk fitohet shumë “para pa mund të madh” sesa duke studiuar në universitetet me tepri me tarifat e tyre të larta).

Nëse duam që ekonomia në të ardhmen të rigjallërohet me kompetencën e saj profesionale dhe të krijohet një mirëqenie afatgjatë, atëherë do të nevojiten një sërë masash, të cilat do të merren edhe me këshillimin profesional dhe planifikimin e karrierës. Krahas ofertave të tilla këshillimore në zyrat e punës dhe në shkolla duhet gjithashtu të ofrohen kurrikula të orientuara drejt nevojave të tregut të punës, si dhe kurse praktike të detyrueshme në të gjitha llojet e shkollave. Bartësit kryesorë të këtyre masave duhet të jenë zyrat e punës në bashkëpunim me punëdhënësit dhe shkollat.

Të gjitha reformat e mira kërkojnë një planifikim strategjik, bashkëpunim dhe durim.

Në përgjithësi, reformat kërkojnë kohë të gjatë për të dhënë rezultate. Kush kujton se reformat afatshkurtra të anonçuara me shumë zhurmë do të ndryshonin diçka, le të shohë në historinë e larmishme të reformave të Shqipërisë. Shumë gjëra hyjnë shumë shpejt dhe, madje, po aq shpejt janë hedhur poshtë ose janë ndryshuar. Në letër (dhe në prezantimin publik) janë bërë shumë më tepër nga ana sasiore sesa është bërë nga ana cilësore në realitet. Reformat kanë efekt vetëm nëse ato i përshtaten vendit dhe kushteve fillestare. Ato nuk mund të kopjohen nga vendet e tjera, por nga shembujt e mirë mund të mësohet shumë. Reformat do të bëhen realitet vetëm nëse ato do të zbatohen për vendin dhe shtetasit e tij dhe jo sa për “shfaqje politike”. Të gjitha reformat mund të japin rezultat vetëm nëse ato do të ndërmerren dhe mbështeten nga të gjithë aktorët. Politika e mëparshme, nga lart poshtë sot nuk është më e qëndrueshme dhe është e destinuar të dështojë. Sot, të gjitha palët e prekura (punëdhënësit, ekspertët përkatës, shkencëtarët, shoqëria civile etj.) duhet të përfshihen sepse njohuritë e tyre do të pasurojnë rezultatet dhe përgjegjshmëria e tyre do të mundësojë realizimin e reformave.

E njëjta gjë vlen edhe për reformën e arsimit profesional. Nëse të gjithë aktorët japin kontributin e tyre maksimal për një arsim profesional më të mirë, atëherë do të nevojiten kriteret e përshtatshme: për disa nevojiten investime financiare (pajisje dhe materiale të shkollës, vende për të kryer praktikën, masa nxitëse dhe këshilluese), ndërsa nga të tjerët kërkohet kohë (kualifikime shtesë për personelin arsimor etj.). Edhe më e rëndësishme është që të fillohet mundësisht sa më shpejt me hapat e planifikimit dhe të punës!

Shkollat profesionale: Sot ende një punim fragmentar...

Nga më shumë se 400 shkolla profesionale dikur, sot kanë mbetur vetëm 40 të tilla. Arsyet qëndrojnë në neglizhencën e konsiderueshme të politikës arsimore në dekadat e shkuara. Ky “punim fragmentar” i mbetur përbëhet nga disa modele tepër interesante dhe të suksesshme të organizatave të huaja mbështetëse, veçanërisht nga BE-ja, Europa dhe shkollat e tjera, të cilat vazhdojnë të operojnë (pa bërë hapa përpara) si më parë. E gjithë kjo është dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme përmes analizash për qeverinë nga ekspertë vendas dhe të huaj.

Në fillim të një reforme duhen vendosur “kulla fenerësh”, kjo do të thotë që modelet janë krijuar dhe zbatuar në praktikë. Këto “kulla fenerësh”, megjithëse të pakta në numër, janë përvoja të mira dhe kanë dhënë rezultate. Ka “qendra shumëfunksionale”, ka oferta të orientuara drejt praktikës për nivele të ndryshme ose dhe bashkëpunime specifike me botën e punës. Një fazë tjetër e reformës duhet të synojë të transmetojë këto përvoja modelesh në shkolla të tjera, të cilat nuk e njohin ende mirë arsimin profesional modern. Pra, duhet të krijohen më shumë “kulla fenerësh”. Kjo nuk duhet lënë në dorë të donatorëve të huaj përkatës, pasi atyre nuk duhet t’u jepet mandati për të ndërtuar në një vend tjetër për të ngritur seksione të sistemit arsimor kombëtar. Kjo është dhe do të mbetet detyrë e vetë shtetit, i cili, bashkërisht me donatorët, ndërton hap pas hapi një sistem arsimor profesional të përgjithshëm dhe publik për të cilin duhet të përgjigjet më vonë. Dikur kjo masë mbështetjeje nga të huajt nuk do të jetë më.

... por nesër një ofertë gjithëpërfshirëse, cilësore dhe publike!

Kur Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit Europian, ajo do të ketë nevojë për një treg pune me fuqi punëtore të mirëkualifikuar, si dhe për një ekonomi të modernizuar. Në fakt, BE-ja nuk është rrugë njëdrejtimëshe, përkundrazi, hapja e kufijve të saj për vendet e sotme kandidatë do të thotë edhe hapje e këtyre vendeve, si Shqipëria, për fuqi punëtore të kualifikuar dhe për sipërmarrje nga vendet e tjera të BE-së. Nëse Shqipëria nuk përgatitet për këtë, ajo ndoshta do të befaset nga fluksi i fuqisë punëtore të huaj, e cila lë pak hapësirë për punëmarrësit vendas nëse ato nuk janë të kualifikuar ose janë të kualifikuar keq.

Nënndarje për ndërtimin e një sistemi arsimor profesional shqiptar

Fillimisht duhet supozuar që në të ardhmen do të ketë një arsim profesional në vend, i cili të orientohet në kushtet e vendit si edhe në sfidat ekonomike të së ardhmes. Ndryshe nga shumica e vendeve të Europës, të cilat ofrojnë përvojat e tyre të arsimit profesional në Shqipëri, ekonomia shqiptare është qartësisht e përbërë nga ndërmarrje të vogla dhe mikro. Për të ofruar një arsim të mirë dhe cilësor dhe për të përfshirë ndërmarrjet përkatëse, janë të rëndësishme bashkëpunimet e ndërmarrjeve dhe të degëve (pothuajse askush nuk mund të ofrojë i vetëm një arsim praktik të mirë. Madje, pikërisht këtu, modeli shqiptar i së ardhmes do të dallojë qartësisht nga shumë modele të Europës Perëndimore) por ky model mund të mësojë shumë nga këto përvoja dhe t'i përshtasë ato. Një tjetër veçori janë dallimet aktuale në nevojat rajonale. Ka zona rurale në të cilat kanë prioritet kualifikime të tjera për zhvillimin e ekonomisë, sesa p.sh. në qytetet e mëdha me sfera të punës administrative në rritje. Një analizë e plotë e tregut të punës, si dhe një planifikim strategjik i ekonomisë për secilin rajon do të duhet të jetë pjesë përbërëse thelbësore për zhvillimin e profileve kualifikuese përkatëse.

Jo kopje të modeleve ekzistuese – Partneritet midis shtetit dhe ofruesve të huaj për një zhvillim të pavarur

Meqenëse kushtet dhe nevojat shqiptare duhet të jenë në plan të parë të politikës së arsimit profesional, është i pashmangshëm një bashkëpunim i ngushtë dhe afatgjatë midis shtetit dhe ekspertëve të huaj. Si veçmas, ashtu edhe përkrah njëra-tjetrës, të dyja palët nuk mund të zhvillojnë një model të përshtatshëm, i cili me punëtorë të kualifikuar e bën ekonominë shqiptare të konkurrueshme edhe në BE. Një aspekt thelbësor për një ofertë të arsimit profesional gjithëpërfshirës në të ardhmen janë gjithashtu edhe dallimet ekstreme mes zonave urbane-rurale në zhvillimin e Shqipërisë. Jo më kot, prej disa kohësh ka një eksod rural kërcënues, pasi familjet në zonat rurale nuk shohin më të ardhme për fëmijët e tyre. Pra, pikërisht atje duhen marrë masa për të ofruar mundësi kualifikimi dhe punësimi, pasi vetëm qytetet nuk mund të ofrojnë për të gjithë punë dhe mjete për të përballuar jetesën. Duke pasur parasysh vështirësitë e shumta lokale, duhet që të ndërtohen më shumë konvikte për nxënësit e shkollave profesionale.

Gjërat e mira kanë nevojë për kohë, prandaj të fillohet menjëherë

Për shumë arsye, tema e arsimit profesional dhe edukimit të orientuar drejt botës së punës nuk është e përshtatshme për të ndërmarrë iniciativa afatshkurtra. Së pari, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit duhet të fillojnë të ndryshojnë mënyrën e të menduarit ose, të paktën, të fillojnë të mendojnë për të. Prindërve dhe fëmijëve të tyre duhet t'u tregohen alternativa të qarta dhe të besueshme, punëdhënësit duhet të reflektojnë mbi zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë të ndërmarrjeve të tyre nëpërmjet një personeli më të mirëkualifikuar, mësuesit duhet të trajnohen vazhdimisht, shkollat duhet të jenë të pajisura me mjete moderne, pasi të mësuarit në praktikë nuk mund të bëhet me mjete mësimore të shekullit të kaluar dhe ekspertët, politika, mësuesit dhe punëdhënësit duhet të punojnë bashkërisht për kurrikulat e arsimit profesional të së ardhmes dhe orientimit të të mësuarit. Vetëm kështu mund të fitohet fuqi punëtore e mirëkualifikuar për nevojat e ndryshme të ekonomisë, e cila duhet, të jetë e aftë dhe e gatshme për t'u arsimuar vazhdimisht në mënyrë të pavarur. Gjithashtu degët e veçanta duhen rregulluar në mënyrë të tillë që të zgjerohen gradualisht: Një mekanik i ri makinash duhet të ketë mundësinë që në një të ardhme të fillojë edhe studimet në degën e inxhinierisë, një sekretare ambicioze të synojë për të vazhduar në degën e ekonomisë. Një model i shkallëzuar i orientimit profesional dhe i arsimit do të ishte në këtë rast gjithashtu i përshtatshëm për t'u integruar në normat e diplomave të BE-së.

Autor

Frank Hantke

Folësit:

- Etleva Sakajeva
- Sabine Hartig
- Anette Kasten
- Prime minister, Edi Rama
- Ambassador, Hellmut Hoffman
- Jürgen Hollstein
- Ministri Arben Ahmetaj
- Minister, Blendi Klosi
- Dafina Peci

Moderatorët:

- Ardian Hackaj
- Anette Kasten
- Sonila Limaj
- Skënder Dule
- Etleva Vertopi

Reporterët:

- Dafina Peci
- Enian Lamce
- Megi Llubani
- Sokol Kondi
- Gentiola Madhi
- Fiorin Dervishi
- Brenton Kotorri
- Albana Zeqaj

Listë e publikimeve të tjera të profilit

- Zhvillimi Ekonomik-Arsimi Profesional-Mirëqenie për Shqipërinë
<http://www.fes-tirana.org/media/publications/pdf-files/2014/p-140207wirtschafts-broschure-alb.pdf>
- BEOGRANA - SFIDAT E ARSIMIT NË SHQIPËRI DHE SERBI, PARË NGA KËNDVËSHTRIMI I TË RINJVE
<http://www.fes-tirana.org/media/publications/pdf-files/2015/t-150519-beograna-eng1.pdf>
- TRENDET E PUNËSIMIT RINOR NË SHQIPËRI: CFARË KËRKON NGA TREGU?
<http://www.fes-tirana.org/media/publications/pdf-files/2015/t-150427-tregu-punes-alb.pdf>
- RINIA SHQIPTARE 2015: Ndryshim i ngadaltë, mbështetje tek interneti dhe ...besim tek BE!
<http://www.fes-tirana.org/media/publications/pdf-files/2015/t-150915-rinia-shqiptare-alb.pdf>

Fondacioni Friedrich Ebert në Shqipëri (FES)

Zyra e FES-it në Tiranë është hapur në vitin 1991. Fushat kryesore të aktivitetit tonë janë:

- Shoqëri Civile Aktive:** Ne punojmë me organizata dhe shoqata që janë të angazhuara në mënyrë aktive në zhvillimin shoqëror dhe demokratik të vendit.
- Zhvillimi Social-Ekonomik:** Ne punojmë së bashku me aktorë të ndryshëm në ekonomi. Ne krijojmë platforma dialogimi që kontribuojnë në bilancin e drejtë të interesave dhe rritjes së qëndrueshme.
- Demokratizimi i Institucioneve:** Ne ndihmojmë institucionet të jenë kompetente e të punojnë në mënyrë të pavarur dhe për të mirën e shqiptarëve. Ligjet dhe rregulloret duhet të respektohet nga të gjithë.
- Dialogu dhe pjesëmarrja në botën e punës:** Ne ofrojmë një platformë diskutimi dhe dialogu. Sindikatat duhet të jenë kompetente dhe punëdhënësit mund të gjejnë zgjidhje më të mira për problemet ekonomike.
- E ardhmja e të rinjve:** Pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare është nën moshën 30 vjeç. Të rinjtë kanë nevojë për „të pasur zë“, arsim të mirë dhe perspektiva reale. Ata duan dhe munden të ndërtojnë të ardhmen e Shqipërisë.
- Integrimi në BE:** Ne ndihmojmë Shqipërinë për të qënë anëtare e denjë e Bashkimit Evropian sa më shpejt të jetë e mundur. Për këtë ne ofrojmë shkëmbimit rajonal dhe ndërkombëtar përvojash.

www.fes-tirana.org

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA)

Në fund të vitit 2008, u themelua në Shqipëri Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë, e cila ka qenë funksionale që nga mesi i vitit 2009. Ajo përfaqëson rrjetin e kompanive gjermane dhe shqiptare në vend si dhe ndërmjetëson të gjitha kompanitë gjermane të cilët dëshirojnë të hyjnë në tregun shqiptar. Me mbi 60 anëtarë, DIHA është një nga shoqatat më të rëndësishme dypalëshe ekonomike në Shqipëri. Anëtarët e DIHA-s gëzojnë shërbimet e mëposhtme:

- Kontakte:** Avantazhe nëpërmjet rrjetit tonë me organizatat e tjera ekonomike (të biznesit), institucioneve shtetërore dhe kompanive, në Shqipëri dhe Gjermani.
- Rregjistri i anëtarësisë:** Kompania juaj do të listohet në rregjistrin tonë rajonal online të anëtarësisë, i cili shfrytëzohet nga shumë kompani për të krijuar kontakte. Anëtarët kanë akses mbi këto të dhëna (kontakte).
- Rrjetëzim:** Në aktivitetet tona të shumta ju mund të krijoni një rrjet aktiv.
- Përfaqësim interesash:** Shoqata përfaqëson interesat e kompanive gjermane me interesa biznesi në Gjermani.

www.albanien.ahk.de

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) në Shqipëri

GIZ punon që prej vitit 1988 në emër të Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) në Shqipëri. Puna e saj fokusohet në:

- Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Këtu përfshihet arsimi profesional, promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe përmirësimi i klimës së investimeve.
- Furnizimin me ujë dhe kanalizimet.
- Zhvillimin bujqësor dhe rural: përmirësimi i mundësive të të ardhurave në fshat, duke përfshirë rajone të varfra të pafavorizuara malore.
- Integrimin Evropian: përarfrimi ligjor në sektorin e ekonomisë (me fond e të BMZ) dhe ngritja e strukturave për të promovuar zhvillimin rural (si mandatues me fonde të BE-së).
- Fonde të hapura rajonale për Evropën Juglindore: një mjet fleksibël për promovimin e punësimit rajonal për nxitjen/promovimin e reformës ligjore, tregtisë së jashtme, modernizimit të shërbimeve komunale dhe eficiencës së energjisë dhe energjive të ripërtëritshme.
- Ekspertë të integruar. Qendra për Migrim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (CIM) siguron me kërkesë të institucioneve shqiptare profesionistë të fushave të ndryshme.

www.giz.de

